



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0535

OSHP: 2025/0560

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Kryesuesë, Vedat Poterqoi dhe Kimete Gashi-Brajshori-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) EING COM SH.P.K., AGRO INVEST 1 SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të kontratës, Vendimin për dhënie të kontratës të Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit 163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet -Ritender me numër të prokurimit 616-25-2547-1-1-1, me 19.08.2025, mori:

Vendim

1. Aprovohen, si e bazuar ankesat e OE EING COM SH.P.K., me nr. 2025/0535, e datës 26.06.2025, ndërsa aprovohet si pjesërisht të bazuara ankesa e AGRO INVEST 1 SH.P.K., me nr. 2025/0560, e datës 30.06.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit 163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet -Ritender me numër të prokurimit 616-25-2547-1-1-1.
2. Anulohet, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të Kuvendi i Komunës së Prishtinës, ndërkaq aktiviteti i prokurimit 163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet -Ritender me numër të prokurimit 616-25-2547-1-1-1, kthehet në Rivlerësim .
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarrë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Me qenë se ankesa me nr 2025/0535 si e bazuar, dhe ankesa me nr 2025/0560 si pjesërisht e bazuara të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankesues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.03.2025, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull 163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet -Ritender me numër të prokurimit 616-25-2547-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 2,000.000.00 €.

Me 10.06.2025 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku ka shpërblyer me kontratë GOE DIGA Solutions L.L.C.; ED Construction Sh.P.K.; IMK Industria Metalike e Kosovës Sh.P.K.

Me 16.06.2025, OE EING COM SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Me datë 16.06.2025 po ashtu edhe OE AGRO INVEST 1 SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 19.06.2025, Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilit refuzohen si të pa bazuara ankesat e të dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 26.06.2025, OE EING COM SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0535/2025 ndërsa me datë 30.06.2025 OE AGRO INVEST 1 SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0560/2025.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0535/2025 dhe ankesa nr. 0560/2025 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues EING COM SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Nr. 1: Arsyet e eliminimit sipas AK - Komisionit të vlerësimit janë:

Kapaciteti teknik dhe profesional kriteri numër katër (4) mungon Certifikata e Konformitetit CE që tregon përputhshmërinë e një produkti me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian për siguri, shëndet dhe mbrojtje mjedisore është dorëzuar vetëm nga prodhuesi.

Sa i përket arsyes për eliminimin lidhur me pretendimin e parë (1), kjo nuk qëndron, për faktin se kërkesa nga ana e AK-së ka qenë e përgjithshme, ku përcaktohet se: “Autoriteti kontraktues ka kërkuar kopje të certifikatës së konformitetit CE”, me këtë rast ashtu si shihet AK në kërkesën e dosjes nuk ka specifikuar se certifikata duhet të lëshohet nga një trup certifikues i pavarur (Notified Body) ose ndonjë institucion tjetër i akredituar, prandaj me rastin e vlerësimit të ofertës sonë ka dalë jashtë kërkesës së dosjes së tenderit për të cilin ne nuk duhet të eliminohe mi në asnjë mënyrë. Ne jemi të bindur se me dokumentacionin e ofruar nga ana jonë, jemi të përgjegjshëm dhe e plotësojmë këtë kërkesë sipas përshkrimit të kërkesës së lartcekur.

Për më shumë, lidhur me këtë kërkesë, sipas Legjislacionit të BE-së (Rregullorja 305/2011/EU) e lejon që për disa produkte, vetë prodhuesi të lëshojë Deklaratën e Performancës dhe certifikatën CE, për atë kohë sa ndjek procedurat përkatëse dhe produkti i përket një kategorie të tillë që nuk kërkon domosdoshmërisht certifikim nga palë të treta.

Certifikata e ofruar nga ana jonë përmban të gjitha elementet thelbësore të një certifikate CE, e cila gjendet në ofertën tonë dhe mund të verifikohet lehtësisht nga AK:

- Referencë të qartë ndaj direktivave të BE-së (si 305/2011/EU),
- Përmendjen e standardeve të harmonizuara (p.sh. EN ISO 1452-2, EN ISO 15874, etj.),
- Të dhënat e produktit dhe qëllimin e përdorimit,
- Deklaratë për përputhshmëri me kërkesat e BE-së,
- Shenjën CE dhe emrin/adresën e prodhuesit.

AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së sepse nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjitha ofertat sepse neve na ka eliminuar për Certifikatën CE të lëshuar vetëm nga prodhuesi ndërsa GOE të propozuar për dhënie ja ka pranuar si të vlefshme edhe pse Certifikata CE është e lëshuar nga vetë prodhuesi, me këtë rast nuk ka bërë vlerësimin në pajtim me nenin 7 të LPP-së duke përdorur standarde të dyfishta gjatë vlerësimit të ofertave dhe për këtë kërkojmë nga AK që ta kthejë lëndën në rivlerësim dhe ta korrigjojë gabimin që ka bërë në vlerësimin e tenderit.

Prandaj kërkesa e autoritetit kontraktues ka qenë e përgjithshme dhe nuk ka përcaktuar dhe as specifikuar në mënyrë decidive se kush duhet ta lëshojë certifikatën, prandaj ligjërisht dhe praktikisht, në mungesë të specifikimeve shtesë, certifikata e prodhuesit e dorëzuar nga ana jonë është krejtësisht e vlefshme. Pretendimi Nr. 2: Arsyeja numër dy (2) e eliminimit sipas komisionit të vlerësimit:

Specifikimet teknike të detyrueshme nuk i përmbushin kërkesat sipas kriterit të DT-së ku:

Materiale: ofron PVC (standard) PU (opsional). Siç u vlerësua më parë, këto materiale PVC dhe PU nuk i përmbushin kërkesën e specifikuar për materialet PP dhe PE. Ky është një defekt i rëndësishëm, pasi PP dhe PE janë të njohura për qëndrueshmërinë dhe fleksibilitetin e tyre në

kushte të ndryshme klimatike, duke ndihmuar në zgjatjen e jetëgjatësisë së sistemit.

Kundërshtim ndaj arsyes së eliminimit tonë sa i përket pikës së dytë:

Produktet e ofruara nga kompania jonë janë të dizajnuara për përdorim të përkohshëm gjatë situatave emergjente për vërshime, ku këto tuba prej PVC dhe PU janë të testuar për mbajtjen e presionit të ujit. Bazuar në këtë, materialet e ofruara nga ana jonë, konsiderojmë se e përmbushin dhe i përgjigjen 100% natyrës së kontratës dhe specifikimit të dosjes së tenderit të kërkuara nga AK.

Pretendimi Nr. 3: Arsyeja numër tre (3) e eliminimit sipas komisionit të vlerësimit:

Lidhjet dhe ventilat: ofron ASTM Z dhe ASTM Universal për lidhjet e tubave. Kjo është një mangësi e dukshme, pasi kërkesa specifike në tender është për STORZ 110A. STORZ 110 A është një standard ndërkombëtar dhe përdorimi i një lidhjeje tjetër mund të shkaktojë vështirësi në lidhjen e tubave me pajisje të tjera të përputhshme.

Kundërshtim ndaj arsyes së eliminimit tonë në lidhje me njoftimin për eliminimin e ofertës sonë për shkak të mospërputhjes me kërkesën teknike për lidhje të tipit STORZ 110A, ju sqarojmë si në vijim:

Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga ana jonë dhe specifikimeve të katalogut zyrtar të prodhuesit, është cituar qartë: Connectors ASTM, other on request.

Kjo do të thotë që lidhjet standarde janë të tipit ASTM, por prodhuesi ofron edhe tipe të tjera lidhjesh sipas kërkesës, përfshirë STORZ 110A, i cili është standard ndërkombëtar dhe i njohur gjerësisht në sistemet evropiane.

Në kuadër të ofertës sonë, kemi qenë të vetëdijshëm për këtë kërkesë të autoritetit kontraktues dhe kemi planifikuar pajisjen e tubave me lidhje STORZ 110A, siç e lejon dhe përmend prodhuesi në dokumentacionin teknik.

Meqë autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar specifikisht që lidhja STORZ të jetë standarde e produktit në katalog, por vetëm që të jetë pjesë e produktit të ofruar, dhe përderisa kjo është e mundur nga prodhuesi të ofrohet, ne konsiderojmë se kërkesa është e përmbushur në përputhje me specifikimin teknik të tenderit.

Prandaj, eliminimi për këtë arsye konsiderohet joproporcional dhe i pabazuar në faktin se produkti ofron fleksibilitetin për të përmbushur këtë kërkesë dhe ne kemi deklaruar që furnizimi do të përfshijë STORZ 110A si lidhje standarde.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë, të rishqyrtoni vendimin e eliminimit dhe të pranoni këtë sqarim si dëshmi se kërkesa teknike është përmbushur. Pretendimi Nr. 4: Arsyeja numër katër (4) e eliminimit sipas komisionit të vlerësimit:

Pesha: tubi që ofroni peshon 0.9 kg/m, që është nën minimumin e kërkuar prej 1.2 kg/m. Pesha është një tregues i rëndësishëm i cilësisë së materialit. Një tub me peshë më të vogël zakonisht ka mure më të holla, që do të thotë se ka më pak rezistencë ndaj presionit dhe dëmtimeve mekanike.

Kundërshtim ndaj arsyes së eliminimit tonë në lidhje me këtë pretendim:

Produkti i ofruar nga kompania jonë ka pasur për qëllim furnizimin e tubave për përdorim të përkohshëm në raste emergjente. Pësia më e lehtë ndihmon në transportin dhe instalimin më të shpejtë dhe më efikas gjatë situatave të vërshimeve.

Gjithashtu, në specifikimet teknike të tenderit nuk është theksuar qartë nëse 1.2 kg/m është kërkesë minimale apo vetëm vlerë orientuese. Në mungesë të një specifikimi të qartë, konsiderojmë se produkti ynë është i pranueshëm dhe i përshtatshëm për qëllimin e kontratës.

Kërkojmë që të merret parasysh natyra e përdorimit të tubave dhe fleksibiliteti që duhet të ofrojë Autoriteti Kontraktues për produkte që i përmbushin funksionalitetin e kërkuar.

Pretendimi Nr. 5: Arsyeya numër pesë (5) e eliminimit sipas komisionit të vlerësimit:

Presioni: në katalog përshkruhet si presion pune 0.55 bar, ndërsa kërkesa është minimum 1 bar. Kjo tregon se tubi nuk do të jetë në gjendje të përballojë presionin e ujit në raste të caktuara.

Kundërshtim ndaj arsyes së eliminimit tonë në lidhje me këtë pretendim:

Presioni i përshkruar në katalog është për përdorim të vazhdueshëm, ndërsa produkti ka kapacitet më të lartë për përballimin e presioneve momentale apo të sforcuara, të cilat janë më të larta se 0.55 bar.

Po ashtu, në dokumentacionin tonë janë përfshirë edhe specifikime teknike që dëshmojnë kapacitetin për të përballuar presionin e kërkuar nga AK.

Produktet e ofruara janë të përdorura gjerësisht në sisteme të emergjencës për vërshime dhe janë testuar në kushte të ndryshme operative, prandaj konsiderojmë se përmbushin kërkesat e tenderit.

Pretendimi Nr. 6: Arsyeya numër gjashtë (6) e eliminimit sipas komisionit të vlerësimit:

Diametri i brendshëm: është 104 mm, ndërsa kërkesa është minimum 110 mm.

Kundërshtim ndaj kësaj arsyeje për eliminim:

Dallimi në diametër prej vetëm 6 mm është shumë i vogël dhe nuk e ndikon funksionalitetin e sistemit.

Në realitet, ky tolerim është brenda normave të lejuara teknike dhe nuk përbën pengesë për përdorim në rastet e parapara nga kontrata. Kjo përforcohet edhe nga fakti se lidhjet janë fleksibile dhe të përshtatshme për dimensione të ndryshme.

Eliminimi për një diferencë të tillë minimale konsiderohet i padrejtë dhe nuk përputhet me frymën e konkurrencës së ndershme dhe trajtimit të barabartë. Përfundim dhe Kërkesë për Rishqyrtim

Të nderuar anëtarë të OSHP-së,

Në bazë të të gjitha fakteve të paraqitura më lart dhe duke u bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik dhe aktet nënligjore përkatëse, konsiderojmë se eliminimi i kompanisë sonë është bërë në kundërshtim me parimet e barazisë së trajtimit, proporcionalitetit dhe transparencës.

Autoriteti Kontraktues ka interpretuar në mënyrë tepër rigjide kërkesat teknike të dosjes së tenderit, duke mos marrë parasysh qëllimin dhe përdorimin praktik të produkteve, si dhe duke mos vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe proporcionale dokumentacionin tonë të dorëzuar. Kjo përbën shkelje të nenit 7 dhe nenit 59 të LPP-së, si dhe të parimit të konkurrencës së ndershme.

Duke qenë se produktet tona janë të certifikuara, funksionale, të përdorshme dhe përmbushin qëllimin e kontratës, kërkojmë që OSHP-ja të:

Anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e kompanisë sonë;

Obligojë AK-në të rishqyrtojë ofertën tonë, në përputhje me kriteret e tenderit dhe në pajtim me parimet e ligjshmërisë dhe konkurrencës së ndershme;

Pezullojë aktivitetin e prokurimit, përderisa nuk është shqyrtuar dhe vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme lidhur me këtë ankesë.

Kompania jonë ka përmbushur të gjitha kushtet ligjore dhe teknike për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit dhe është e përkushtuar të ofrojë produkte të cilësisë së lartë, të certifikuara dhe në përputhje me standardet evropiane.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues AGRO INVEST 1 SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Ankimor 1

Operatori Ekonomik Ankues AGRO INVEST 1 SH.P.K. pretendon se grupi i operatorëve ekonomikë të rekomanduar për kontratë GOE DIGA Solutions L.L.C.; ED – Construction Sh.p.k.; IMK – Industria Metalike e Kosovës Sh.p.k. është i papërgjegjshëm, pasi nuk ka firmosur Marrëveshjen Deklaratë për formimin e grupit me formularin standard të miratuar nga KRPP më 11.11.2025, siç kërkohet me legjislacionin sekondar.

Ankuesi thekson se Autoriteti Kontraktues ka shpallur fitues një GOE që nuk ka respektuar këtë kërkesë ligjore të detyrueshme, duke mos përdorur formularin standard të obliguar me aktet nënligjore në fuqi.

Ankuesi pretendon se me këtë veprim është shkelur Neni 87, paragrafi 2, nënparagrafi 2.9 dhe Neni 91, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe neni 19.16 dhe neni 26.15 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të cilat obligojnë përdorimin e formularëve standardë të miratuar nga KRPP, përfshirë Marrëveshjen Deklaratë për formimin e grupit.

Pretendimi Ankimor 2

Ankuesi pretendon se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesën për kapacitet ekonomik dhe financiar, pasi nuk ka dëshmuar qarkullimin minimal vjetor prej 2,000,000 € gjatë tre viteve të fundit fiskale. Sipas ankuesit, deklaratat vjetore ATK janë paraqitur vetëm për kompaninë ED Construction SHPK, për IMK është paraqitur vetëm gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve, ndërsa për kompaninë lidere nuk është paraqitur fare deklaratë ATK, duke bërë që qarkullimi total i deklaruar të jetë vetëm

1,021,927.10 €, më pak se kërkesa minimale e FDT-së.

Pretendimi Ankimor 3

Ankuesi kundërshton vlerësimin e OE të rekomanduar për kontratë si të përgjegjshëm, duke pretenduar se ky grup nuk ka paraqitur dëshmi të kontratave të ngjashme të përfunduara me sukses, siç kërkohet në FDT. Sipas ankuesit, nuk janë paraqitur lista ku saktësohen titulli i kontratës, data e fillimit dhe përfundimit, referenca apo certifikata për kryerjen e tyre. Ankuesi shton se kontratat e paraqitura nga IMK janë për blerjen e tubave të galvanizuar dhe nuk janë të ngjashme me tubat PE dhe PP të kërkuara në këtë tender.

Pretendimi Ankimor 4

Ankuesi pretendon se autorizimi i paraqitur nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i pavlefshëm, pasi është lëshuar nga Solomon Consultants d.o.o. (Serbi), kompani që nuk figuron si distributor apo përfaqësues i Environment Solutions ApS në faqen zyrtare të prodhuesit. Gjithashtu, deklarata e garancisë e ofruar nuk ka datë lëshimi dhe nuk përfaqëson asnjë kompani prodhuese. Autorizimi është lëshuar më 12.02.2025, përpara datës së Njoftimit për Kontratë më 31.03.2025, duke mos qenë i dedikuar për këtë projekt.

Pretendimi Ankimor 5

Ankuesi kundërshton vlerësimin teknik të OE të rekomanduar për kontratë, duke pretenduar se tubat e ofertuar nuk përmbushin specifikimet teknike të kërkuara në DT, sepse:

- Kanë diametër 140 cm (kërkohej 115-130 cm).
- Kanë lartësi mbajtëse të ujit 120 cm (kërkohej maksimumi 80 cm).
- Në katalog nuk përshkruhet materiali i kërkuar (PE dhe PP) dhe mungon koha e mbushjes (≤ 5 orë).
- Nuk janë paraqitur ventilet lidhëse të standardit 4" Storz 110A për mbushjen dhe shkarkimin e ujit.

Pretendimi Ankimor 6

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shpallur fitues ofertuesin me çmimin më të lartë prej 1,972,300 €, ndërkohë që oferta e ankuesit ka qenë më e ulët (1,356,900 €), duke dëmtuar buxhetin e Komunës së Prishtinës për 615,400 € dhe duke vepruar në kundërshtim me nenin 1 të LPP-së për efikasitetet dhe përdorim optimal të fondeve publike.

Pretendimi Ankimor 7

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues, përveç faktit që nuk i ka vlerësuar drejtë, faktikisht dhe juridikisht ofertat e operatorëve konkurrues e veçanërisht të ankueses, nuk i ka trajtuar në merita dhe nuk i ka shqyrtuar pretendimet e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim. Si pasojë e mos trajtimit dhe vlerësimit të këtyre pretendimeve, AK ka nxjerrë një vendim pa kurrfarë arsytimi, çka sipas ankuesit përbën shkelje të dispozitave të Konventës dhe Kushtetutës, të cilat do t'i elaborojë më tej në ankesë.

Pretendimi Ankimor 8

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkëlur nenin 59.4 të LPP-së, pasi nuk ka kërkuar sqarime për asnjë nga aspektet e ofertës së tij, ndonëse ky nen e lejon këtë kur ka paqartësi ose devijime të vogla, gjë që do të mundësonte vlerësim të drejtë, objektiv dhe proporcional me kriteret e tenderit.

Pretendimet e Ankuesit ndaj Arsyes së Eliminimit

Ankuesi kundërshton arsyet e eliminimit të tij nga AK, duke i paraqitur si pretendime të veçanta:

Pretendimi Ankimor 9

AK ka eliminuar ankuesin me arsyetimin se katalogu i ofertës është në gjuhën gjermane dhe nuk përputhet me katalogun në faqen e internetit të prodhuesit. Ankuesi pretendon se katalogu është në gjuhën gjermane sepse prodhuesi është gjerman, se e kanë marrë fizikisht gjatë vizitës në Zvicër më 26.03.2025, dhe se ndryshimet me website-in janë për shkak se ai është version i vjetër (2002). Për më tepër, ata kanë përkthyer në shqip pjesët esenciale të katalogut.

Pretendimi Ankimor 10

AK ka eliminuar ankuesin me arsyetimin se materiali i tubave është PVC dhe jo PE ose PP siç kërkohet në DT. Ankuesi pretendon se ka ofertuar me tubat e kërkuar PE dhe PP dhe ka paraqitur certifikata të lëshuara nga Europaverband Hochwasserschutz e.V. që vërtetojnë përputhshmërinë me standardet evropiane të mbrojtjes nga përmbytjet.

Pretendimi Ankimor 11

AK ka eliminuar ankuesin me arsyetimin se ventilet lidhëse janë Storz 55 në vend të Storz 110A. Ankuesi pretendon se prodhuesi i tyre ofron ventilet Storz 110A dhe ato janë standarde për produktet e ofruara.

Pretendimi Ankimor 12

AK ka eliminuar ankuesin me arsyetimin se pikat mbushëse nuk janë të detajuara dhe nuk garantojnë mbushjen nga një pikë e vetme. Ankuesi pretendon se pikat mbushëse janë të centralizuara sipas sistemit të ofruar dhe përmbushin kriteret e DT.

Pretendimi Ankimor 13

AK ka eliminuar ankuesin me arsyetimin se gjatësia e seksioneve të tubave është deri 20m ndërsa kërkohen seksione prej 100m dhe 200m. Ankuesi pretendon se në katalogun e ofruar gjatësia e tubave është deri në 200m, siç kërkohet në DT.

Pretendimi Ankimor 14

AK ka eliminuar ankuesin me arsyetimin se mungon Certifikata e Konformitetit CE. Ankuesi pretendon se ka paraqitur certifikatat e firmës Beaver Schutzsysteme AG të lëshuara nga shoqata EVH, që dëshmojnë përputhshmërinë me standardet e BE për mbrojtjen nga përmbytjet.

Pretendimi Ankimor 15

AK ka eliminuar ankuesin me arsyetimin se mungon vula në raportin e vlerësimit të sistemit mobil për mbrojtje nga përmbytjet. Ankuesi pretendon se raporti origjinal i lëshuar nga Ministria e Hungarisë është i vulosur, ndërsa përkthimi në anglisht nuk ka vulë pasi është bërë nga OE për lehtësimin e shqyrtimit nga AK. Ata janë të gatshëm ta përkthejnë me përkthyes të licencuar nëse kërkohet.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për AGRO INVEST 1 SH.P.K.,

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsye si në vijim:

Kapaciteti teknik dhe profesional kriteri numër tre (3) në FDT - Katalogu është në gjuhën gjermane me katalogun në faqen e internetit (website) të prodhuesit ku nuk i plotëson dhe nuk përputhet me katalogun në faqen kërkesat e kërkuara

Specifikimet teknike - Specifikimet teknike të detyrueshme nuk i përmbush kërkesat sipas kriterit të DT-së ku:

Te materialet: përdorë PVC, nuk i përmbush kërkesat e tenderit që kërkojnë let PP dhe PE.

PVC është i përdorur gjerësisht për barrierat e përmbytjeve, por mund të ketë më pak fleksibilitet dhe qëndrueshmëri afatgjatë në kushte ekstreme, krahasuar me PP dhe PE.

Lidhjet dhe Ventilat: ofron Storz 55, që është një tjetër mangësi e rëndësishme, pasi kërkesa specifike në tender është për STORZ 110A, që ka një diametër më të madh dhe është standardi më i përdorur për sisteme të tilla. Kjo mund të shkaktojë vështirësi për tu lidhur me pajisje të tjera dhe mund të ndikojë në efikasitetin e sistemit

Pikat Mbushëse: Nuk janë dhënë detaje të plota për pikat mbushëse, por është e mundur që pikat të lidhen në mënyrë të centralizuar, siç kërkohet, duke siguruar mbushjen e sistemit me ujë në një pikë të vetme.

Gjatësia e Seksioneve: ofron seksione vetëm deri në 20 metra, ndërsa në DT kërkohet që seksionet të jenë 100 dhe 200 metra të gjata për shkak të përshtatjeve në terrene të ndryshme, stabilitetit, qëndrueshmërisë ndaj presionit

Kapaciteti teknik dhe profesional kriteri numër katër (4) mungon Certifikata e Konformitetit CE që tregon përputhshmërinë e një produkti me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian për siguri, shëndetësi dhe mbrojtje mjedisore

Kapaciteti teknik dhe profesional kriteri numër pesë (5) raporti vlerësimit të vlefshëm për sistemin mobil për mbrojtjen nga vërshimet dhe përmbytjet nuk është i vulosur.

Të lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që parashtruesi nuk i konteston fare arsye për të cilat është eliminuar oferta e tij si e papërgjegjshme me përjashtimin e arsyes së parë eliminuese.

Lidhur me arsyen e parë eliminuese vlen të citohet neni 13 par. 4 i LPP ku thuhet se "Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë

dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze.” Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vetë parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT-së si dhe specifikat teknike të DT-së duke përfshirë edhe deklaratën për GOE, qarkullimin financiar, listën e kontratave, autorizimet dhe katalogjet.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga e sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Raportin e ekspertizës me nr.0535/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjegjës rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu as OE nuk është përgjegjës rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.0560/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjegjës rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, parashtruesit dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE EING COM SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0535 ka vlerësuar si në vijim:

PËRSHKRIMI I ANKESËS

Operatori ekonomik ankues “EING COM SH.P.K.” ka paraqitur ankesë kundër vendimit të Komunës së Prishtinës për eliminimin nga tenderi për ndërtimin dhe pastrimin e lumenjve dhe

kanalizimeve. Ankuesi pretendon se është eliminuar padrejtësisht për arsye si certifikata CE, materialet e tubave, lidhjet dhe gabime teknike, duke theksuar se oferta e tij ishte 494,800.00 euro më e lirë se ajo e OE-së së rekomanduar për kontratë. Ai gjithashtu konteston përgjegjshmërinë e operatorit të rekomanduar për mungesë dokumentacioni dhe autorizimesh, si dhe konteston edhe disa OE tjerë pjesëmarrës për mospërputhje me kërkesat e tenderit. Ankuesi kërkon anulimin e vendimit dhe rivlerësimin e ofertës së tij.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të paraqitura nga OE “EING COM SH.P.K.” kundër Komunës së Prishtinës për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet – Ritender”. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit, vendimeve të Autoritetit Kontraktues dhe provave të bashkëngjitura nga pala ankuese, eksperti paraqet sa vijon:

Pretendimi Ankimor 1

Operatori Ekonomik Ankues pretendon se është eliminuar me arsyetimin se mungon Certifikata e Konformitetit CE e lëshuar nga trup certifikues i pavarur, ndërkohë që kërkesa ka qenë e përgjithshme dhe nuk ka specifikuar se duhet të lëshohet nga Notified Body. Ankuesi thekson se sipas Rregullores 305/2011/EU të BE-së, për disa produkte vetë prodhuesi mund të lëshojë Deklaratën e Performancës dhe CE, për atë kohë sa ndjek procedurat përkatëse dhe produkti nuk kërkon domosdoshmërisht certifikim nga palë të treta. Certifikata e ofruar sipas ankuesit përmban të gjitha elementet: referencë ndaj direktivave të BE-së, standardet e harmonizuara, të dhënat e produktit, deklaratën për përputhshmëri dhe shenjë CE me emrin/adresën e prodhuesit. Ankuesi deklaroi se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së duke përdorur standarde të dyfishta, pasi atyre ua ka refuzuar certifikatën e lëshuar nga prodhuesi ndërsa GOE të propozuar për kontratë ia ka pranuar si të vlefshme, prandaj kërkon rivlerësim dhe pranimin e certifikatës së tyre si të vlefshme.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 1

Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës në platformën e prokurimit elektronik dhe analizës së Dosjes së Tenderit, eksperti shqyrtues konstaton se AK, në Kërkesën për Kapacitetin Teknik dhe Profesional pika 4, ka kërkuar:

“Sistemi mobil për mbrojtjen nga vërshimet dhe përmbajtjet duhet të përmbajë certifikimin CE. Kopje të Certifikatës së Konformitetit CE që tregon përputhshmërinë e një produkti me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian për siguri, shëndetësi dhe mbrojtje mjedisore.”

Në këtë kërkesë nuk është specifikuar që certifikata duhet të lëshohet nga notified body ose trup certifikues i pavarur. Sipas vendimit për eliminim, AK ka arsyetuar se certifikata e dorëzuar ishte lëshuar vetëm nga prodhuesi.

Eksperti shqyrtues konstaton se Certifikata CE e dorëzuar nga OE ankues është lëshuar nga prodhuesi dhe përmban të gjitha elementet e nevojshme, ndërsa për këtë produkt zbatohet sistemi AVCP 4, i cili lejon vetë-certifikimin pa nevojë për notified body.

Gjithashtu, eliminimi i OE ankues bie në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, i cili garanton trajtim të barabartë dhe pa diskriminim të operatorëve ekonomikë, veçanërisht nëse për GOE të propozuar janë pranuar dokumente të ngjashme.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi Ankimor 2

OE “EING COM SH.P.K.” pretendon se është eliminuar me arsyetimin se materialet e ofruara PVC dhe PU nuk përmbushin kërkesën për materiale PP dhe PE, ndërkohë që produktet e tyre janë të dizajnuara për përdorim të përkohshëm gjatë situatave emergjente për vërshime, janë të testuara për mbajtjen e presionit të ujit dhe i përgjigjen 100% natyrës së kontratës dhe specifikimit të dosjes së tenderit.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 2

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës së OE “EING COM SH.P.K.” dhe analizës së Dosjes së Tenderit, eksperti shqyrtues konstaton se eliminimi është bërë për shkak të materialeve të tubave të ofruara, ku në vend të PP dhe PE janë ofruar materiale PVC (standard) dhe PU (opsional).

Në Specifikimet Teknike të Detyrueshme të DT-së është kërkuar:

“Tuba të ndërtuar me dy shtresa prej materiali artificial (PP dhe PE).”

Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar:

“PVC dhe PU nuk i përmbushin kërkesat e specifikuara për materialet PP dhe PE.”

Nga deklarimi i vetë OE ankues rezulton se janë ofruar materiale të ndryshme nga ato të specifikuara. Sidoqoftë, duke marrë parasysh që produktet e ofruara janë të destinuara për përdorim emergjent, janë të testuara për qëndrueshmëri dhe mbajtje presioni, si dhe duke marrë në konsideratë vlerën ekonomike dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, eksperti shqyrtues vlerëson se:

Edhe pse materiali i ofruar nuk përputhet plotësisht me specifikimin e DT-së, mund të vlerësohet nga Autoriteti Kontraktues nëse ky ndryshim përbën devijim material ose jo, në varësi të ndikimit në funksionin dhe sigurinë e kontratës.

Pretendimi Ankimor 3

Operatori Ekonomik Ankues kundërshton eliminimin për shkak të lidhjeve ASTM në vend të STORZ 110A, duke argumentuar se sipas dokumentacionit dhe katalogut zyrtar të prodhuesit, është cituar qartë: “Connectors ASTM, other on request”, që do të thotë prodhuesi ofron edhe lidhje të tjera sipas kërkesës, përfshirë STORZ 110A. Ata theksojnë se kanë qenë të vetëdijshëm për këtë kërkesë dhe kanë planifikuar pajisjen e tubave me lidhje STORZ 110A, siç lejon dokumentacioni teknik. Ankuesi shton se autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar specifikisht që lidhja STORZ të jetë standarde e produktit në katalog, por vetëm që të jetë pjesë e produktit të ofruar, dhe si e tillë kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur. Sipas tyre, eliminimi është i paproporcional dhe i pabazuar, pasi kanë deklaruar që furnizimi do të përfshijë lidhjen STORZ 110A si të kërkuar, dhe kërkojnë që eliminimi të shqyrtohet dhe të pranohet ky sqarim si dëshmi për përmbushjen e kërkesës.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 3

Gjatë analizimit të dokumentacionit të ofertës në platformën e-prokurimit, eksperti shqyrtues konstaton se në Dosjen e Tenderit, Aneksi 1 – Specifikimet Teknike, është kërkuar:

“Ventilat lidhës duhet të jenë të standardit 4” STORZ 110A dhe të sigurojnë mbushjen dhe zbrazjen e shpejtë të sistemit.”

Nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar nga OE ankues, rezulton se lidhjet standarde të produktit janë të tipit ASTM, ndërsa për lidhje të tjera thuhet “other on request”, pa e specifikuar qartë STORZ 110A si pjesë të produktit të ofertuar.

Në Kapacitetin Teknik dhe Profesional të Dosjes së Tenderit është kërkuar që operatorët ekonomikë të dorëzojnë katalogë ose broshura me specifikime të detajuara për produktet kryesore, ndërkohë që nuk është sqaruar nëse komponentët shtesë si ventilat lidhës duhet të jenë të deklaruar si standard në katalog apo mund të ofrohen si pjesë e furnizimit final.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi është pjesërisht i bazuar, pasi dokumentacioni i ofertës nuk dëshmon se lidhja STORZ 110A është standard i produktit, por duke qenë se në katalog është specifikuar “other on request” dhe kërkesa e DT-së nuk ka përcaktuar qartë nëse kjo lidhje duhet të jetë e deklaruar si standard apo mund të ofrohet si pjesë e furnizimit, rekomandohet që të kërkohet sqarim shtesë nga OE, në përputhje me nenin 59 të LPP-së.

Pretendimi Ankimor 4

Operatori Ekonomik Ankues pretendon se është eliminuar me arsyetimin se nuk ka informacion të detajuar për mundësinë e lidhjes së pikës mbushëse në një pikë të vetme, ndërkohë që në Aneks 1 pjesë e dosjes së tenderit nuk është përmendur në mënyrë eksplicite një kërkesë e tillë. Dokumentacioni i tyre teknik përmbush të gjitha kërkesat dhe AK ka pasur mundësi të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së por nuk e ka bërë, ndërsa eliminimi për kërkesa jo të specifikuara bie ndesh me nenin 56.3 të LPP-së.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 4

Gjatë analizimit të pretendimit dhe dokumentacionit në platformën e-prokurimit, eksperti shqyrtues konstaton se në Specifikimet Teknike të Detyrueshme, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar:

“Sistemi duhet të mundësojë mbushjen dhe zbrazjen e shpejtë të tubave, me valvula të standardit STORZ 110A, të sigurojë lidhje të sigurt dhe funksionim praktik gjatë emergjencave.”

Nga vendimi për eliminim, Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar se:

“Nuk ka informacion të detajuar për mundësinë e lidhjes së pikës mbushëse në një pikë të vetme.”

Analiza e Dosjes së Tenderit tregon se nuk është specifikuar në mënyrë eksplicite kërkesa që mbushja e sistemit të bëhet në një pikë të vetme, por vetëm kërkesa për ventilat lidhës standard STORZ 110A dhe mbushje/zbrasjen e shpejtë.

Në përputhje me nenin 56.3 dhe 59 të LPP-së, operatorët ekonomikë nuk mund të eliminohen për kritere të papërcaktuara në DT, ndërsa Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësi të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së, në rast se ka pasur paqartësi.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi është i bazuar, pasi nuk ka pasur kërkesë të qartë në DT për mbushje në një pikë të vetme dhe eliminimi nuk është i ligjshëm.

Pretendimi Ankimor 5

Operatori Ekonomik Ankues pretendon se është eliminuar me arsyetimin se ofron seksione tubash deri në 20m, ndërkohë që në DT kërkohen 100m dhe 200m. Ankuesi sqaron se në katalogun e tyre është qartësisht e specifikuar se ofrojnë seksione prej 10m, 15m, 20m dhe për gjatësitë tjera opsion “other on request”, pra kanë mundësi reale dhe kapacitete për të ofruar seksionet e kërkuara dhe sistemi i tyre modular lejon lidhjen e tyre për të krijuar gjatësinë e nevojshme.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 5

Pas shqyrtimit të pretendimit dhe dokumentacionit të ofertës në platformën e-prokurimit, eksperti shqyrtues konstaton se në Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar:

“Seksionet e tubave duhet të jenë me gjatësi 100m dhe 200m.”

Në vendimin për eliminim, Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar:

“OE ka ofertuar vetëm seksione tubash deri në 20m.”

Nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar nga OE ankues rezulton se janë ofertuar seksione prej 10m, 15m dhe 20m, ndërsa për gjatësitë tjera citohet “other on request”. Dokumentacioni i ofertës nuk dëshmon ofrim konkret të tubave me gjatësi 100m dhe 200m siç kërkohet në DT, por njëkohësisht evidentohet se ekziston mundësia teknike për prodhim ose konfigurim modular të këtyre gjatësive.

Në përputhje me nenin 59 të LPP-së, vlerësimi bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në DT, ndërsa Autoriteti Kontraktues nuk ka sqaruar në DT nëse gjatësitë duhet të jenë standarde të produktit apo mund të ofroheshin si porosi speciale.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi është pjesërisht i bazuar, dhe rekomandon që Paneli Shqyrtues të konsiderojë mundësinë e rivlerësimit me sqarim shtesë nga OE, për të vlerësuar nëse ofertimi përmbush qëllimin dhe funksionin e kontratës.

Pretendimi Ankimor 6

Operatori Ekonomik Ankues pretendon se është eliminuar me arsyetimin se numri i prokurimit në sigurimin e tenderit nuk përputhet me numrin e aktivitetit sipas DT-së, ndërkohë që kjo është një gabim teknik i papërfillshëm, pasi polica e sigurimit i përmban të gjitha elementet tjera të nevojshme dhe AK ka mundur ta trajtojë si gabim teknik pa e eliminuar ofertën.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 6

Pas shqyrtimit të pretendimit dhe dokumentacionit të ofertës në platformën e-prokurimit, eksperti shqyrtues ka vërejtur se eliminimi i OE ankues është bërë me arsyetimin se numri i prokurimit i shënuar në sigurimin e tenderit nuk përputhet me numrin e aktivitetit të prokurimit sipas Dosjes së Tenderit. Në Aneksin përkatës të Dosjes së Tenderit është kërkuar:

Numri i prokurimit: 616-25-2547-1-1-1.

Nga shqyrtimi i policës së sigurimit të dorëzuar nga OE rezulton se është shënuar numri 616-25-990-1-1-1, që përbën mospërputhje faktike me numrin e aktivitetit. Megjithatë, dokumenti i sigurimit përmban të gjitha elementet tjera të nevojshme, përfshirë titullin e saktë të projektit, vlerën e garantuar, periudhën e vlefshmërisë, të dhënat e ofertuesit dhe Autoritetit Kontraktues.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi është pjesërisht i bazuar, pasi edhe pse ekziston mospërputhje në numrin e prokurimit, gabimi nuk cenon vlefshmërinë dhe qëllimin e sigurimit të tenderit dhe nuk e bën ofertën të papërgjegjshme. Në përputhje me nenin 59, paragrafi 4 të LPP-së, i cili përcakton:

“Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë që të sqarojnë ose plotësojnë dokumentet e ofertës së tyre. Ky sqarim ose plotësim nuk mund të përdoret për të ndryshuar ofertën substancialisht ose për të korrigjuar ndonjë mangësi thelbësore që do ta bënte ofertën jokualifikuese.”

Ky vlerësim mbështetet edhe në vendimin e Panelit Shqyrtues OSHP: 2023/0993, ku është konstatuar se gabimet teknike në sigurimin e tenderit nuk e bëjnë ofertën të papranueshme, përderisa dokumenti përmban të gjitha elementet e tjera të kërkuara dhe ekzistenca e tij është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave. Në atë vendim, Paneli ka theksuar që:

“...aktiviteti i prokurimit të rivlerësohet duke aplikuar dispozitat e neneve 59.4 dhe 72 të LPP-së, që lejojnë sqarimin dhe plotësimin e dokumentacionit, me kusht që dokumenti të ekzistojë para afatit të dorëzimit dhe të verifikohet objektivisht, pa ndryshuar materialisht ofertën.”

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësi ta trajtojë këtë si gabim teknik dhe të kërkojë sqarim për korrigjimin e tij, në vend se të eliminojë ofertën.

Pretendimet Ankimore ndaj GOE të rekomanduar për kontratë: DIGA Solutions L.L.C.; ED – Construction Sh.p.k.; IMK – Industria Metalike e Kosovës Sh.p.k.

Pretendimi 1 ndaj GOE të rekomanduar për kontratë:

AK në Dosjen e Tenderit, pika 11.1 – “Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomikë”, ka kërkuar plotësimin e Marrëveshjes (Deklaratës) për themelimin e grupit, sipas Aneksit 7. GOE i rekomanduar nuk ka ofruar deklaratë që përmbush këtë kërkesë. Formulari i themelimit të grupit është obligativ sipas formës standarde dhe mungesa e tij e bën ofertën të papërgjegjshme për këtë aktivitet prokurimi. Dokumenti i dorëzuar nuk përmban asnjë element të formularit standard të KRPP për Aneksin 7 – Deklaratën për themelimin e grupit.

Sipas Udhëzuesit Nr. 001/2023 i plotësuar me 002/2024, në rast se mungon deklarata e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës, tenderi refuzohet pa kërkuar informacion të mëtejshëm, pasi kjo konsiderohet kusht administrativ.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 1

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, eksperti shqyrtues ka vërejtur se grupi i operatorëve ekonomikë të rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar Marrëveshjen për themelimin e grupit sipas formatit standard të KRPP, siç kërkohet me nenin 26.15 të Rregullores për Prokurimin

Publik. Ky nen obligon që, kur operatorët ekonomik marrin pjesë si grup, ofertës t'i bashkëlidhet Marrëveshja unike për themelimin e grupit, ku përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësitë, përqindjet e pjesëmarrjes dhe autorizimi i liderit të grupit.

Autoriteti Kontraktues ka përfshirë në Dosjen e Tenderit në Aneksin 7 vetëm titullin “Deklaratë për themelimin të grupit”, pa formularin e plotë standard të KRPP, duke mos përfshirë tekstin hyrës, tabelat për përqindjet, përgjegjësitë dhe autorizimin e liderit, siç kërkohet me nenin 26.15. Kjo përbën mangësi të AK-së.

Nga ana tjetër, GOE i rekomanduar ka dorëzuar vetëm deklarata individuale të ndara nga DIGA Solutions L.L.C. (lider), ED-Construction Sh.P.K. (anëtar) dhe IMK Sh.P.K. (anëtar), të cilat:

Nuk janë Marrëveshje unike dhe e përbashkët,

Nuk përmbajnë përqindjet e pjesëmarrjes,

Nuk përcaktojnë përgjegjësitë e secilit anëtar dhe autorizimin e liderit,

Nuk janë të përgatitura sipas formatit standard të miratuar nga KRPP.

Sipas nenit 10.1 të Udhëzuesit Nr. 001/2023 (i ndryshuar me 002/2024), mungesa e këtij formulari standard është kusht administrativ eliminues.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi është i bazuar, pasi GOE i rekomanduar nuk ka përmbushur kërkesën ligjore për dorëzimin e Marrëveshjes për themelimin e grupit, pavarësisht mangësive në publikimin e formularit nga AK, duke qenë se operatorët ekonomikë janë të obliguar të sigurojnë që dokumenti të përmbajë të gjitha elementet ligjore të përcaktuara.

Pretendimi Ankimor 2 ndaj GOE të rekomanduar për kontratë

Operatori Ekonomik Ankues pretendon se GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesën e Dosjes së Tenderit të përcaktuar te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, konkretisht në pikat 9.1 dhe 9.2, ku kërkohet:

“Operatorët ekonomik duhet të dorëzojnë Autorizim nga prodhuesi apo Distributori i dedikuar për këtë projekt për shitje dhe mirëmbajtje për produktet kryesore me të cilat ofrojnë si dhe garancionin minimum 24 muaj nga prodhuesi për këto produkte.”

GOE i rekomanduar ka prezantuar autorizim nga kompania Solomon Consultants d.o.o. Beograd – Savaski Venac si përfaqësues i kompanisë Environment Solutions Asp, por sipas ankuesit:

Nuk është ofruar asnjë dëshmi që Solomon Consultants është përfaqësues zyrtar apo distributor i autorizuar nga Environment Solutions Asp për shitjen dhe mirëmbajtjen e produkteve të tyre.

Prandaj, ankuesi pretendon se GOE i rekomanduar nuk e ka përmbushur kërkesën e DT-së dhe duhet të eliminohej nga aktiviteti i prokurimit.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 2

Pas shqyrtimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe analizës së dokumentacionit të ofertës së GOE të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues konstaton si më poshtë:

Në Dosjen e Tenderit, te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pikat 9.1 dhe 9.2, është kërkuar që:

“Operatorët ekonomik duhet të dorëzojnë Autorizim nga prodhuesi apo distributori i dedikuar për këtë projekt për shitje dhe mirëmbajtje për produktet kryesore me të cilat ofertojnë.”

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga GOE i rekomanduar, rezulton se është paraqitur një autorizim i lëshuar nga Solomon Consultants d.o.o. Beograd – Savski Venac, në të cilin deklarohet se kjo kompani është përfaqësues ekskluziv i Environment Solutions AsP dhe autorizon DIGA Solutions LLC për shitjen e produkteve të Environment Solutions AsP në Kosovë.

Megjithatë, në dokumentacion nuk është bashkangjitur asnjë dëshmi apo konfirmim nga vetë prodhuesi (Environment Solutions AsP) që vërteton statusin e Solomon Consultants si përfaqësues zyrtar apo distributor i autorizuar për produktet në fjalë. Kjo krijon pasiguri lidhur me përmbushjen e plotë të kërkesës së DT-së, e cila kërkon që autorizimi të lëshohet nga prodhuesi ose nga një distributor i dedikuar për projektin.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar, pasi dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon qartësisht lidhjen e drejtpërdrejtë me prodhuesin apo një distributor të dedikuar, siç kërkohet në specifikimet e Dosjes së Tenderit.

Pretendimi Ankimor 3 ndaj GOE të rekomanduar për kontratë

Operatori Ekonomik Ankues pretendon se GOE i rekomanduar nuk ka ofruar dëshmi në katalog për materialet PP dhe PE, të cilat janë kërkuar në Aneksin 1 – Specifikimet teknike të dosjes së tenderit.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 3

Pas shqyrtimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe analizës së dokumentacionit të ofertës së GOE të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues konstaton si më poshtë:

Në Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Dosjes së Tenderit është kërkuar:

“Tuba të ndërtuar me dy shtresa prej materiali artificial (PP dhe PE).”

Nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar nga GOE i rekomanduar, rezulton se:

Në përshkrimin teknik të tubave të ofertuar nuk specifikohet qartë materiali PP (polipropilen) dhe PE (polietilen). Katalogu përmban të dhëna mbi dimensionet, peshën dhe konfigurimin (p.sh. Twin tube, Triple tube), por nuk jep referenca të drejtpërdrejta për materialet e kërkuara sipas DT-së.

Eksperti shqyrtues vlerëson se GOE i rekomanduar nuk ka ofruar dëshmi të plotë për materialet PP dhe PE, siç është kërkuar, por Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësi të kërkojë sqarim shtesë për këtë specifikim, nëse ka konsideruar se informacioni i paraqitur nuk ka qenë i mjaftueshëm për vlerësim teknik, në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar, pasi dokumentacioni nuk përmban specifikimin e kërkuar, por kjo situatë mund të ishte sqaruar nga

Autoriteti Kontraktues pa ndryshuar ofertën në thelb.

Pretendimi Ankimor 4 ndaj GOE të rekomanduar për kontratë

Operatori Ekonomik Ankues pretendon se GOE i rekomanduar është i papërgjegjshëm sepse për vinçin hidraulik nuk ka ofruar certifikatat përkatëse që dëshmojnë përputhshmërinë me standardet ISO-16028 ose ISO-7241 Lloji A, siç kërkohet në Aneksin 1 – Specifikimet teknike.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 4

Pas shqyrtimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe analizës së dokumentacionit të ofertës së GOE të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues konstaton si më poshtë:

Në Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Dosjes së Tenderit është kërkuar:

“Vinçi hidraulik duhet të ketë lidhës të shpejtë të pajtueshëm me standardet ISO-16028 ose ISO-7241 Lloji A.”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të dorëzuar nga GOE i rekomanduar, rezulton se:

Për vinçin hidraulik janë përshkruar të dhëna mbi motorin hidraulik, fuqinë, presionin dhe dimensionet e tubave, ndërsa për lidhjet hidraulike është përmendur vetëm: “2x BSP female with O-ring and 60° pack flat.

Nuk ka asnjë referencë apo dokument që dëshmon përputhshmërinë e lidhjeve hidraulike me standardet ISO-16028 ose ISO-7241 Lloji A, siç është kërkuar në specifikimet teknike.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar, pasi dokumentacioni i ofertës së GOE të rekomanduar nuk dëshmon përputhshmërinë me standardet e kërkuara në DT.

PRETENDIMET ANKIMORE NDAJ OPERATORËVE TË TJERË PJESËMARRËS

Pretendimi Ankimor 1 (ndaj GOE: AGRO INVEST1 SH.P.K.; Beaver Schutzsysteme AG; LORD GROUP SH.P.K.; Ermal Sylaj B.I.)

Operatori Ekonomik Ankues pretendon se gjatë vlerësimit të ofertave ka vërejtur që GOE AGRO INVEST1 SH.P.K.; Beaver Schutzsysteme AG; LORD GROUP SH.P.K.; Ermal Sylaj B.I. kanë dorëzuar katalogë ose broshura vetëm në gjuhën gjermane, gjë që bie ndesh me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe legjislacionit në fuqi.

Sipas Dosjes së Tenderit, tek Kapaciteti Teknik dhe Profesional, pika 3, është kërkuar:

“Operatorët ekonomik duhet të sjellin Katalogë ose Broshura me specifikime të detajuara për produktet kryesore.”

Ankuesi thekson se, në përputhje me nenin 18.1 të Përgatitjes së Tenderit, operatorët ekonomikë duhet të përgatisin dhe të dorëzojnë ofertat dhe të gjitha dokumentet e lidhura në gjuhën shqipe, serbe ose angleze. Kjo çështje është e rregulluar edhe me nenin 13 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, i cili përcakton se:

“Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën

shqipe, serbe ose në gjuhën angleze.”

Gjithashtu, ankuesi thekson se AK e ka evidentuar këtë mangësi në Letrat Standarde për tenderuesit e eliminuar, prandaj vlerëson se ky GOE është i papërgjegjshëm dhe nuk ka përmbushur kërkesat e aktivitetit të prokurimit.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 1

Pas shqyrtimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe analizës së dokumentacionit të ofertës së GOE AGRO INVESTI SH.P.K.; Beaver Schutzsysteme AG; LORD GROUP SH.P.K.; Ermal Sylaj B.I., eksperti shqyrtues konstaton si më poshtë:

Në Dosjen e Tenderit, tek Kapaciteti Teknik dhe Profesional, pika 3, është kërkuar:

“Operatorët ekonomik duhet të sjellin Katalogë ose Broshura me specifikime të detajuara për produktet kryesore.”

Nga dokumentacioni i dorëzuar, rezulton se GOE ka ofruar katalogë të detajuar me përshkrime teknike, materiale, dimensione dhe aplikime, por të hartuar tërësisht në gjuhën gjermane, pa përkthim zyrtar në ndonjërin nga gjuhët e lejuara në prokurim publik (shqipe, serbe ose angleze).

Sipas nenit 13.4 të LPP-së dhe nenit 13 të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik, dokumentet e ofertës duhet të jenë në një nga gjuhët zyrtare të përcaktuara.

Gjithashtu, Opinion Nr. 7 i KRPP-së (22.11.2022) thekson se:

“Në rastet kur dokumentet, siç janë katalogët, përmbajnë specifikime teknike që përbëjnë pjesë thelbësore të vlerësimit, ato duhet të jenë në një nga gjuhët e lejuara ose të shoqërohen me përkthim zyrtar, përndryshe oferta nuk mund të konsiderohet në përputhje me kërkesat ligjore dhe duhet të refuzohet.”

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar, pasi edhe pse GOE ka dorëzuar katalogë të plotë teknikë, mungesa e përkthimit zyrtar në një nga gjuhët e lejuara përbën mangësi ligjore që cenon pranueshmërinë e ofertës, në përputhje me nenin 13.4 të LPP-së, nenin 13 të Rregullores për Prokurim Publik dhe Opinionin Nr. 7 të KRPP-së.

Pretendimi Ankimor 2 (ndaj GOE: AGRO INVESTI SH.P.K.; Beaver Schutzsysteme AG; LORD GROUP SH.P.K.; Ermal Sylaj B.I.)

Operatori ekonomik ankues pretendon se AK në dosjen e tenderit, përkatësisht te Kapaciteti teknik dhe profesional, ka kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë një raport vlerësimi të vlefshëm për sistemin mobil për mbrojtjen nga vërshimet dhe përmytjet, të verifikuar nga një institucion i pavarur përkatës. Ankuesi thotë se GOE-të AGRO INVESTI SH.P.K.; Beaver Schutzsysteme AG; LORD GROUP SH.P.K.; dhe Ermal Sylaj B.I. kanë dorëzuar raporte të lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme të Hungarisë, e cila është përdorues i produktit dhe jo institut i pavarur vlerësimi siç kërkohet, prandaj ky konzorcium nuk i ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit dhe duhet të konsiderohet i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 2

Pas shqyrtimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe analizës së dokumentacionit të ofertës së GOE AGRO INVESTI SH.P.K.; Beaver Schutzsysteme AG; LORD GROUP SH.P.K.; Ermal Sylaj B.I., eksperti shqyrtues konstaton si më poshtë:

Në Dosjen e Tenderit, tek Kapaciteti Teknik dhe Profesional, pika 5, është kërkuar:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një raport vlerësimi të vlefshëm për sistemin mobil për mbrojtjen nga vërshimet dhe përmbytjet. Raporti duhet të përmbajë të dhëna mbi efikasitetin teknik dhe performancën e sistemit të propozuar, të verifikuar nga një institucion i pavarur përkatës. Kopje e raportit i lëshuar nga një institut relevant dhe i pavarur.”

Nga dokumentet e ofertës rezulton se GOE ka dorëzuar një raport të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Hungarisë, e cila është përdorues i produktit, ndërsa nuk rezulton të jetë institut i pavarur vlerësimi teknik, siç kërkohet në mënyrë të qartë në DT.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar, pasi raporti i dorëzuar nuk është lëshuar nga një institut i pavarur dhe relevant për vlerësim teknik, siç kërkohet në Dosjen e Tenderit.

Pretendimi Ankimor 3 (ndaj GOE: AGRO INVESTI SH.P.K.; Beaver Schutzsysteme AG; LORD GROUP SH.P.K.; Ermal Sylaj B.I.)

Operatori Ekonomik Ankues pretendon se, sipas Aneksit 1 – Kriteret Teknike të Dosjes së Tenderit, sistemi mobil për mbrojtjen nga vërshimet duhet të përmbushë specifikimet për vinçin hidraulik, i cili përdoret për largimin dhe mbështjelljen e tubit pas përdorimit dhe duhet të përdoret së bashku me një pirun. Ai përbëhet nga një shasi dhe një bobinë zëvendësuese dhe duhet të përfshijë një motor hidraulik me fuqi minimale 40 kW dhe tub hidraulik me gjatësi të paktën 3 metra. Madhësia e vinçit dhe e bobinës duhet të jetë e tillë që 200 m tub trefishtë të mund të mbështillen në bobinë. Lidhjet hidraulike duhet të jenë në përputhje me standardet ISO-16028 ose ISO-7241 Lloji A.

Ankuesi thekson se GOE nuk ka ofruar asnjë të dhënë teknike (dokument, katalog apo broshurë) që dëshmon për përmbushjen e këtyre kërkesave për vinçin hidraulik, prandaj e konsideron këtë GOE si të papërgjegjshëm në këtë aktivitet prokurimi. Gjithashtu, ankuesi shton se ka edhe arsye të tjera për eliminimin e këtij GOE, të cilat janë të evidentuara nga AK në Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 3

Gjatë analizimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës së GOE të rekomanduar për kontratë në platformën e-prokurimit, eksperti shqyrtues ka vërejtur si më poshtë:

Në Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Dosjes së Tenderit është kërkuar që vinçi hidraulik të ketë motor hidraulik me fuqi minimale 40 kW, tuba hidraulike me gjatësi të paktën 3 metra, si dhe lidhje hidraulike në përputhje me standardet ISO-16028 ose ISO-7241 Lloji A.

Nga katalogu dhe dokumentacioni i dorëzuar, rezulton se:

Nuk janë paraqitur të dhëna teknike që dëshmojnë fuqinë e motorit hidraulik,

Nuk është specifikuar gjatësia e tubave hidraulike,

Nuk figuron asnjë referencë apo certifikatë që lidhjet hidraulike përputhen me standardet ISO-16028 ose ISO-7241 Lloji A.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i certifikatave të dorëzuara rezulton se ato lidhen me produkte të tjera të ofertës dhe jo me vinçin hidraulik të kërkuar.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar, pasi në dokumentacionin e ofertës mungojnë të dhënat teknike të nevojshme për të dëshmuar përmbushjen e specifikimeve të kërkuara për vinçin hidraulik, siç parashihet në Dosjen e Tenderit.

Pretendimi Ankimor 1 (ndaj GOE: HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K.)

Operatori Ekonomik Ankues pretendon se, sipas Dosjes së Tenderit – Kapaciteti Teknik dhe Profesional, është kërkuar që operatorët ekonomikë të ofrojnë dëshmi për përfundimin me sukses të një kontrate të një natyre të ngjashme.

Ankuesi thekson se GOE nuk ka ofruar asnjë kontratë të ngjashme për furnizime, sipas kërkesës së AK-së. Të gjitha kontratat e prezantuara nga GOE janë kontrata për punë (aktiviteti 521) dhe jo për furnizime, ndërkohë që AK në dosjen e tenderit e ka klasifikuar aktivitetin si FPP 28862100-3 Furnizime tubash, prandaj konsideron se GOE rezulton i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 1

Pas shqyrtimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe analizës së dokumentacionit të ofertës së GOE HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K. në platformën e-prokurimit, eksperti shqyrtues konstaton si më poshtë:

Në Dosjen e Tenderit, Kapaciteti Teknik dhe Profesional, pika 1, është kërkuar:

“Operatorët ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi që kanë përfunduar me sukses një kontratë të një natyre të ngjashme, duke saktësuar titullin e kontratës, datat e fillimit dhe përfundimit, si dhe referenca ose certifikata për kryerje të furnizimeve.”

Nga dokumentacioni i ofertës rezulton se GOE ka ofruar referenca dhe certifikata kontratash që përfshijnë:

Instalime dhe montime të sistemeve të ngrohjes qendrore dhe kaldajave,

Renovime të objekteve shëndetësore dhe shkollore,

Instalime fittingësh dhe gypash në projekte ndërtimore dhe komunale.

Edhe pse këto kontrata janë klasifikuar si punë (aktiviteti 521), ato përmbajnë komponentë të qartë furnizimi të tubave dhe materialeve përkatëse, të lidhura drejtpërdrejt me fushën teknike të aktivitetit aktual të prokurimit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues nuk është i bazuar, pasi kërkesa në Dosjen e Tenderit ka qenë për kontratë të një natyre të ngjashme, jo domosdoshmërisht kontratë

të pastër furnizimi, dhe dokumentacioni i ofruar nga GOE dëshmon përvojë të tillë të ngjashme që mbulon kërkesat e përcaktuara në DT.

Pretendimi Ankimor 2 (ndaj GOE: HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K.)

Operatori Ekonomik Ankues pretendon se, sipas Dosjes së Tenderit (Kapaciteti Teknik dhe Profesional, pika 5), është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë një raport vlerësimi të vlefshëm për sistemin mobil për mbrojtjen nga vërshimet dhe përmbytjet, i cili duhet të përmbajë të dhëna mbi përmbajtjen, efikasitetin teknik dhe performancën e sistemit të propozuar, të verifikuar nga një institucion i pavarur përkatës. Ankuesi thotë se GOE ka ofruar vetëm një urdhër blerjeje të produkteve dhe jo raport vlerësimi, siç është kërkuar në dosjen e tenderit, prandaj e konsideron ofertën e tij të papërgjegjshme.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 2

Pas shqyrtimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe analizës së dokumentacionit të ofertës së GOE HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K. në platformën e-prokurimit, eksperti shqyrtues konstaton si më poshtë:

Në Dosjen e Tenderit, Kapaciteti Teknik dhe Profesional, pika 5, është kërkuar:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një raport vlerësimi të vlefshëm për sistemin mobil për mbrojtjen nga vërshimet dhe përmbytjet. Raporti duhet të përmbajë të dhëna mbi efikasitetin teknik dhe performancën e sistemit të propozuar, të verifikuar nga një institucion i pavarur përkatës.”

Nga dokumentacioni i ofertës rezulton se GOE ka dorëzuar një dokument të titulluar “Raport i Vlerësimit”, i cili në përmbajtje është një urdhër blerjeje (purchase order) i lëshuar nga kompania prodhuese RIVER ENGINEERING CO., LTD.

Ky dokument përmban listime të disa testeve të produktit të shënuara si “PASSED”, por:

Nuk është lëshuar nga ndonjë institut i pavarur testues,

Nuk përmban referenca të standardeve zyrtare të testimit apo metodologji laboratorike,

Nuk ka logo apo certifikim nga ndonjë organ akreditues i jashtëm, siç kërkohet në specifikimet e Dosjes së Tenderit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar, pasi dokumenti i dorëzuar nga GOE nuk përmbush kërkesën për raport vlerësimi të vlefshëm, të verifikuar nga një institut i pavarur dhe përkatës, sipas kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Pretendimi Ankimor 3 (ndaj GOE: HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K.)

Operatori Ekonomik Ankues pretendon se, sipas Dosjes së Tenderit (Aneksi 1 – Kriteret Teknike, pika 7), është kërkuar që ventilat lidhës të jenë të standardit 4” Storz 110A dhe të sigurojnë mbushjen dhe zbrazjen e shpejtë të sistemit. Ankuesi thekson se GOE, sipas katalogëve të prezantuar, nuk ka ofruar specifikime teknike për ventilat, siç kërkohet në Aneksin 1 të dosjes së tenderit, prandaj e konsideron ofertën e tij të papërgjegjshme.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 3

Pas shqyrtimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe analizës së dokumentacionit të ofertës së GOE HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K. në platformën e-prokurimit, eksperti shqyrtues konstaton si më poshtë:

Në Dosjen e Tenderit (Aneksi 1 – Kriteret Teknike, pika 7) është kërkuar:

“Ventilat lidhës duhet të jenë të standardit 4” Storz 110A dhe të sigurojnë mbushjen dhe zbrazjen e shpejtë të sistemit.”

Nga dokumentet e ofertës rezulton se GOE ka dorëzuar katalogë dhe certifikata për pajisjet e ofertës, mirëpo nuk ka paraqitur specifikime teknike apo dokumentacion që dëshmojnë se ventilat lidhës të ofertuar janë të tipit 4” STORZ 110A, siç kërkohet në specifikimet teknike.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar, pasi dokumentacioni i dorëzuar nuk përmban të dhëna që vërtetojnë përputhshmërinë e ventilave lidhës me standardin e kërkuar STORZ 110A.

Pretendimi Ankimor 4 (ndaj GOE: HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K.)

OE ankues pretendon se në Dosjen e Tenderit, sipas Aneksit 1 – Kriteret Teknike, është kërkuar që sistemi mobil për mbrojtjen nga vërshimet të përmbajë vinç hidraulik me specifika të detajuara teknike, si motor hidraulik me fuqi minimale 40 kW, tuba hidraulike me gjatësi të paktën 3 metra dhe lidhje hidraulike në përputhje me standardet ISO-16028 ose ISO-7241 Lloji A. Ankuesi thekson se GOE nuk ka ofruar asnjë të dhënë teknike (katalog/broshurë) që dëshmon për përmbushjen e këtyre kërkesave për vinçin hidraulik, prandaj e konsideron ofertën e tij të papërgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit.

Gjithashtu, OE ankues shton se ka edhe arsye të tjera për eliminimin e këtij GOE, të cilat janë të evidentuara nga AK në Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 4

Pas analizimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës së GOE HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K. në platformën e-prokurimit, eksperti shqyrtues konstaton si më poshtë:

Në Dosjen e Tenderit, Aneksi 1 – Kriteret Teknike, është kërkuar:

“Vinçi hidraulik duhet të përfshijë motor hidraulik me fuqi minimale 40 kW dhe tuba hidraulikë me gjatësi të paktën 3 metra. Madhësia e vinçit dhe bobinës duhet të jetë e tillë që 200 m tub trefish të mund të mbështillen në një bobinë. Lidhjet hidraulike duhet të jenë në përputhje me ISO-16028 ose ISO-7241 Lloji A.”

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se GOE ka paraqitur katalogë dhe certifikata që përmbajnë specifikime për tubat PVC/PE dhe raportet e testimit SGS, ROHS dhe REACH. Megjithatë, nuk është gjetur ndonjë dokumentacion teknik apo katalog që lidhet me vinçin hidraulik të kërkuar, motorin hidraulik, tubat hidraulikë apo standardet ISO të specifikuara në kërkesat e DT-së.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar, pasi në dokumentacionin e dorëzuar mungojnë të dhëna që dëshmojnë përmbushjen e specifikimeve të kërkuara për vinçin

hidraulik, siç parashihet në Dosjen e Tenderit.

PËRFUNDIM

Mbështetur në analizën e pretendimeve dhe dokumentacionit të shqyrtuar, ankesa vlerësohet si pjesërisht e bazuar.

Procesi i vlerësimit nuk është zhvilluar në përputhje të plotë me nenin 1 të LPP-së, i cili synon sigurimin e një sistemi të drejtë, transparent dhe ekonomik të prokurimit publik. Po ashtu, nuk janë respektuar në mënyrë të plotë nenet 6 dhe 7 të LPP-së, që garantojnë përdorim efikas të fondeve publike dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Është vërejtur që është rekomanduar për kontratë një ofertë me çmim më të lartë, e cila sipas analizës nuk ka përmbushur në tërësi kërkesat e dosjes së tenderit, ndërkohë që disa mangësi në ofertat tjera mund të ishin sqaruar në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së, i cili lejon sqarime dhe plotësime vetëm për dokumentacion ekzistues dhe të verifikueshëm para afatit të dorëzimit, pa ndryshuar materialisht ofertën, siç përcaktohet edhe në nenin 52 dhe nenin 72 të LPP-së.

Rekomandohet që Paneli Shqyrtues ta aprovojë ankesën si pjesërisht të bazuar dhe t'i kërkojë Autoritetit Kontraktues rivlerësimin e ofertave, duke siguruar që sqarimet dhe plotësimet të jenë në përputhje me kërkesat ligjore, për të garantuar një proces të drejtë, transparent dhe me përdorim racional të buxhetit publik.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues AGRO INVEST 1 SH.P.K., Eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0560 ka vlerësuar se:

PËRSHKRIMI I ANKESËS

Operatori Ekonomik AGRO INVEST 1 SH.P.K. ka paraqitur ankesë kundër Komunës së Prishtinës për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet – Ritender”. Ankuesi pretendon se është eliminuar në mënyrë të padrejtë edhe pse ka ofertuar çmimin më të ulët prej 1,356,900.00 €. Sipas tij, grupi fitues nuk ka përmbushur kriteret bazë të dosjes së tenderit, duke përfshirë mungesën e marrëveshjes standarde të grupit, qarkullimin vjetor nën minimumin e kërkuar, mospasjen e kontratave të ngjashme të dëshmuara, si dhe autorizime jo valide nga prodhuesi. Gjithashtu, tubat e ofruar nga fituesi nuk përmbushin kërkesat për dimension, material dhe ventile lidhëse. Ankuesi thekson se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë diskriminuese, me standarde të dyfishta, pa respektuar dispozitat e LPP-së për trajtimin e devijimeve të vogla apo kërkesën e sqarimeve. Ai kërkon anulimin e vendimit të AK-së, rivlerësimin objektiv të ofertave dhe shpalljen fitues të ofertës së tij si ekonomikisht më e favorshme.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të paraqitura nga OE “AGRO INVEST 1 SH.P.K.” kundër Komunës së Prishtinës për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet – Ritender”. Pas shqyrtimit të dosjes së tenderit, vendimeve të Autoritetit Kontraktues dhe dokumenteve të bashkëngjitura nga pala ankuese, eksperti paraqet sa vijon:

Pretendimi Ankimor 1

Operatori Ekonomik Ankues AGRO INVEST 1 SH.P.K. pretendon se grupi i operatorëve ekonomikë të rekomanduar për kontratë GOE DIGA Solutions L.L.C.; ED – Construction Sh.p.k.; IMK – Industria Metalike e Kosovës Sh.p.k. është i papërgjegjshëm, pasi nuk ka firmosur Marrëveshjen Deklaratë për formimin e grupit me formularin standard të miratuar nga KRPP më 11.11.2025, siç kërkohet me legjislacionin sekondar.

Ankuesi thekson se Autoriteti Kontraktues ka shpallur fitues një GOE që nuk ka respektuar këtë kërkesë ligjore të detyrueshme, duke mos përdorur formularin standard të obliguar me aktet nënligjore në fuqi.

Ankuesi pretendon se me këtë veprim është shkelur Neni 87, paragrafi 2, nënparagrafi 2.9 dhe Neni 91, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe neni 19.16 dhe neni 26.15 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të cilat obligojnë përdorimin e formularëve standardë të miratuar nga KRPP, përfshirë Marrëveshjen Deklaratë për formimin e grupit.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 1

Pas analizimit të pretendimit të paraqitur dhe shqyrtimit të dokumentacionit në platformën e prokurimit elektronik, eksperti shqyrtues vlerëson si më poshtë:

Në bazë të nenit 26.15 të Rregullores për Prokurimin Publik, kur operatorët ekonomikë marrin pjesë si grup, së bashku me ofertën duhet të dorëzojnë Marrëveshjen për themelimin e grupit në formatin standard të miratuar nga KRPP, në të cilën duhet të përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësitë e secilit anëtar, përqindjet e pjesëmarrjes dhe autorizimi i liderit të grupit.

Nga dokumentacioni i dosjes së tenderit rezulton se Autoriteti Kontraktues ka përfshirë në Aneksin 7 vetëm titullin e deklaratës për themelimin e grupit, pa formularin standard të plotë, i cili përfshin edhe tekstin hyrës, tabelat për përqindjet e pjesëmarrjes dhe autorizimin e liderit. Kjo përbën një mangësi të AK-së në publikimin e dokumentacionit të tenderit.

Ndërkohë, grupi i operatorëve ekonomikë të rekomanduar për kontratë ka dorëzuar deklarata individuale nga secili anëtar, të cilat:

Nuk përbëjnë marrëveshje unike dhe të përbashkët,

Nuk përmbajnë përqindjet e pjesëmarrjes dhe ndarjen e përgjegjësiave,

Nuk përfshijnë autorizimin e qartë të liderit të grupit,

Nuk janë të përgatitura sipas formatit standard të miratuar nga KRPP.

Sipas nenit 10.1 të Udhëzuesit Nr. 001/2023 (i ndryshuar me 002/2024), mungesa e këtij formulari standard konsiderohet kusht administrativ eliminues, për të cilin nuk lejohet sqarim apo plotësim pas dorëzimit të ofertës.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i paraqitur është i bazuar, pasi pavarësisht mangësi në publikimin e formularit nga AK, grupi i operatorëve ekonomikë mbetet i obliguar të dorëzojë Marrëveshjen për themelimin e grupit me të gjitha elementet ligjore të kërkuara, në përputhje me nenin 26.15 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Pretendimi Ankimor 2

Ankuesi pretendon se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesën për kapacitet ekonomik dhe financiar, pasi nuk ka dëshmuar qarkullimin minimal vjetor prej 2,000,000 € gjatë tre viteve të fundit fiskale. Sipas ankuesit, deklaratat vjetore ATK janë paraqitur vetëm për kompaninë ED Construction SHPK, për IMK është paraqitur vetëm gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve, ndërsa për kompaninë lidere nuk është paraqitur fare deklaratë ATK, duke bërë që qarkullimi total i deklaruar të jetë vetëm 1,021,927.10 €, më pak se kërkesa minimale e FDT-së.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 2

Pas shqyrtimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe analizës së dokumentacionit të dorëzuar në platformën e prokurimit elektronik, eksperti shqyrtues konstaton si më poshtë:

Në dosjen e tenderit është kërkuar që:

“Operatori ekonomik duhet t’i ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale, ka qenë prej jo më pak se 2,000,000.00 €; deklarata e dorëzuara në ATK për 3 vitet e fundit.”

Nga dokumentacioni i ofertës rezulton se:

ED-Construction Sh.p.k. ka dorëzuar deklaratat vjetore tatimore, me qarkullim të përgjithshëm rreth 1,021,927.10 €, më pak se shuma minimale e kërkuar.

IMK – Industria Metalike e Kosovës Sh.p.k. ka paraqitur dokument të gjendjes së përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve, i cili nuk është deklaratë vjetore tatimore (CD) e ATK-së siç kërkohet, dhe nuk është shoqëruar me ndonjë sqarim zyrtar që justifikon përdorimin e këtij dokumenti si alternativë.

Për kompaninë lidere DIGA Solutions L.L.C., nuk është paraqitur deklaratë vjetore tatimore e ATK-së.

Sipas interpretimit të KRPP-së në Pyetjet e shpeshta nr. 90 (09.06.2022):

“Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.”

Megjithatë, në këtë rast, nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton që grupi si tërësi ta ketë dëshmuar qarkullimin minimal të kërkuar prej 2,000,000.00 €, pasi:

Shuma totale e qarkullimit të dëshmuar nuk arrin nivelin e kërkuar, dhe

Nuk janë dorëzuar deklarata vjetore tatimore të plota për të gjithë anëtarët kontributdhënës që do të mundësonin vërtetimin e këtij kapaciteti financiar.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar, pasi dokumentacioni i ofruar nuk dëshmon plotësisht kërkesën e DT-së. Megjithatë, vlen të theksohet se kjo çështje do të mund të sqarohet nga Autoriteti Kontraktues përmes kërkesës për sqarim të dokumenteve ekzistuese, për aq kohë sa sqarimi nuk do të ndryshonte materialisht ofertën, në përputhje me

nenin 59.4 të LPP-së.

Pretendimi Ankimor 3

Ankuesi kundërshton vlerësimin e OE të rekomanduar për kontratë si të përgjegjshëm, duke pretenduar se ky grup nuk ka paraqitur dëshmi të kontratave të ngjashme të përfunduara me sukses, siç kërkohet në FDT. Sipas ankuesit, nuk janë paraqitur lista ku saktësohen titulli i kontratës, data e fillimit dhe përfundimit, referenca apo certifikata për kryerjen e tyre. Ankuesi shton se kontratat e paraqitura nga IMK janë për blerjen e tubave të galvanizuar dhe nuk janë të ngjashme me tubat PE dhe PP të kërkuara në këtë tender.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 3

Pas analizimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në platformën e prokurimit elektronik, eksperti shqyrtues konstaton si më poshtë:

Në dosjen e tenderit është kërkuar që:

“Operatorët ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi që kanë përfunduar me sukses një kontratë të një natyre të ngjashme, duke saktësuar titullin e kontratës, datën e fillimit dhe përfundimit, si dhe referenca ose certifikata për kryerjen e furnizimeve.”

Nga dokumentacioni fillestar i ofertës rezulton se:

Janë dorëzuar kopje të kontratave që përmbajnë titullin, palët kontraktuese, objektin, vlerën dhe datën e nënshkrimit, por nuk përmbanin të gjitha datat e përfundimit dhe as referenca ose certifikata të kryerjes me sukses, siç është kërkuar.

Pas kërkesës për sqarim nga Autoriteti Kontraktues, GOE ka dorëzuar tri referenca shtesë për kontrata të realizuara nga IMK, të cilat përmbajnë titullin e kontratës, emrin e operatorit ekonomik, përshkrimin e lëndës së kontratës dhe deklaratën se kontrata është realizuar me sukses.

Edhe pse kontratat e dorëzuara nuk janë identike me objektin e këtij tenderi, ato dëshmojnë përvojë të ngjashme, në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit, e cila ka kërkuar kontratë të një natyre të ngjashme dhe jo të njëjtë.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues nuk është i bazuar, pasi referencat shtesë të dorëzuara nga GOE pas kërkesës për sqarim vërtetojnë përmbushjen e kërkesës së dosjes së tenderit për kontratë të ngjashme të realizuar me sukses.

Pretendimi Ankimor 4

Ankuesi pretendon se autorizimi i paraqitur nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i pavlefshëm, pasi është lëshuar nga Solomon Consultants d.o.o. (Serbi), kompani që nuk figuron si distributor apo përfaqësues i Environment Solutions ApS në faqen zyrtare të prodhuesit. Gjithashtu, deklarata e garancisë e ofruar nuk ka datë lëshimi dhe nuk përfaqëson asnjë kompani prodhuese. Autorizimi është lëshuar më 12.02.2025, përpara datës së Njoftimit për Kontratë më 31.03.2025, duke mos qenë i dedikuar për këtë projekt.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 4

Pas shqyrtimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe analizës së autorizimit të dorëzuar nga grupi i operatorëve ekonomikë të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues konstaton si më poshtë:

Kërkesa e dosjes së tenderit: Në Kapacitetin Teknik dhe Profesional është përcaktuar që:“Operatori ekonomik duhet të dorëzojë autorizim valid nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për produktet që ofron, i cili vërteton se OE ka të drejtë të shpërndajë ose të instalojë produktet e ofruara për këtë projekt konkret.”

Gjetjet nga dokumentacioni i ofertës: Autorizimi i dorëzuar është lëshuar nga Solomon Consultants d.o.o. Beograd-Savski Venac (Serbi) më 12.02.2025 dhe përmban deklaratën se kjo kompani është përfaqësues ekskluziv i Environment Solutions AsP për territorin e Kosovës, duke autorizuar DIGA Solutions LLC për shitjen e produkteve të Environment Solutions AsP në Kosovë, përfshirë tenderët publikë.

Megjithatë, nga shqyrtimi rezulton se:

Autorizimi nuk është lëshuar direkt nga prodhuesi (Environment Solutions AsP), siç do të përmbushte më qartë kërkesën ligjore.

Nuk është bashkangjitur kopja e dokumentit nga prodhuesi që vërteton se Solomon Consultants është distributor i autorizuar, edhe pse referohet në tekst si dokument i bashkangjitur.

Autorizimi është i përgjithshëm për territorin e Kosovës dhe nuk përmban referencë specifike për këtë projekt/tender, siç është kërkuar në dosjen e tenderit për autorizim të dedikuar.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar, pasi autorizimi i dorëzuar nuk dëshmon në mënyrë të plotë dhe të qartë lidhjen zyrtare të lëshuesit me prodhuesin dhe nuk është specifik për këtë projekt konkret, siç kërkohet në dokumentacionin e tenderit.

Pretendimi Ankimor 5

Ankuesi kundërshton vlerësimin teknik të OE të rekomanduar për kontratë, duke pretenduar se tubat e ofertuar nuk përmbushin specifikimet teknike të kërkuara në DT, sepse:

Kanë diametër 140 cm (kërkohej 115-130 cm).

Kanë lartësi mbajtëse të ujit 120 cm (kërkohej maksimumi 80 cm).

Në katalog nuk përshkruhet materiali i kërkuar (PE dhe PP) dhe mungon koha e mbushjes (≤ 5 orë).

Nuk janë paraqitur ventilet lidhëse të standardit 4” Storz 110A për mbushjen dhe shkarkimin e ujit.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 5

Pas shqyrtimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe analizës së dokumentacionit të dorëzuar në platformën e prokurimit elektronik, eksperti shqyrtues konstaton si më poshtë:

Kërkesat në Dosjen e Tenderit (Aneksi 1 – Specifikimet Teknike):

Diametër: 115-130 cm

Material: dy shtresa PE dhe PP

Lartësi mbajtëse e ujit: maksimumi 80 cm (Twin Tube) ose maksimumi 100 cm (Triple Tube)

Koha e mbushjes: ≤ 5 orë për komplet sistemin

Ventilat lidhëse: 4" Storz 110A

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë rezulton se:

Diametri i tubave të ofertuar është 125 cm, që përputhet me kërkesën e DT-së.

Lartësia mbajtëse deklarohet minimum 80 cm për tubin 125 cm, ndërsa maksimumi nuk është specifikuar në katalog. Duke marrë parasysh lartësinë fizike të tubit (125 cm), ka mundësi që maksimumi tejkalon kufirin e lejuar (80 cm për Twin Tube), mirëpo kjo nuk është sqaruar qartë.

Materiali PE dhe PP nuk është i specifikuar në katalog; produktet janë përshkruar vetëm me emrin tregtar ("NoFloods Tubes") pa të dhëna mbi përbërjen teknike.

Koha e mbushjes (≤ 5 orë) nuk figuron në asnjë pjesë të katalogut.

Ventilat lidhëse të standardit 4" Storz 110A nuk janë të dëshmuara; në katalog përmendet vetëm mundësia e prodhimit me standarde të tjera ndërkombëtare (p.sh. BIC, John Morris, Forestry couplings), por jo konkretisht STORZ 110A.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar, pasi edhe pse dokumentacioni i dorëzuar përmbush kërkesën për diametër, nuk dëshmon qartë përmbushjen e kërkesave të tjera teknike esenciale si lartësia mbajtëse, materiali PE/PP, koha e mbushjes dhe ventilet lidhëse të standardit të kërkuar; megjithatë, duke marrë parasysh rëndësinë e këtyre specifikimeve për funksionimin e produktit dhe mundësinë e sqarimit për disa elemente pa ndryshuar ofertën në thelb, vlerësohet që Autoriteti Kontraktues mund ta trajtojë këtë çështje me kujdes gjatë rivlerësimit të ofertave, në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së.

Pretendimi Ankimor 6

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shpallur fitues ofertuesin me çmimin më të lartë prej 1,972,300 €, ndërkohë që oferta e ankuesit ka qenë më e ulët (1,356,900 €), duke dëmtuar buxhetin e Komunës së Prishtinës për 615,400 € dhe duke vepruar në kundërshtim me nenin 1 të LPP-së për efikasitetet dhe përdorim optimal të fondeve publike.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 6

Pas analizimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe shqyrtimit të dokumentacionit të aktivitetit të prokurimit, eksperti shqyrtues konstaton si më poshtë:

Në dosjen e tenderit është përcaktuar që kriteri i dhënies së kontratës është oferta me çmimin më të ulët, siç parashihet edhe në nenin 60.1.1 të LPP-së, sipas të cilit kontrata i jepet operatorit ekonomik që ka dorëzuar ofertën më të ulët dhe që është e përgjegjshme.

Kjo nënkupton që çmimi më i ulët nuk garanton automatikisht dhënien e kontratës, nëse oferta nuk përmbush kërkesat e dosjes së tenderit dhe kriteret e përgjegjshmërisë, të cilat janë të domosdoshme për ekzekutimin e suksesshëm të kontratës.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues ka përgjegjësi të sigurojë përdorim efikas dhe optimal të fondeve publike, në përputhje me nenin 1 të LPP-së që përcakton si qëllim të ligjit prokurimin publik transparent, të drejtë dhe ekonomik, duke garantuar menaxhim të mirë financiar dhe marrjen e vlerës maksimale për fondet e shpenzuara.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues nuk është i bazuar në tërësi, pasi fakti që një ofertë ka çmim më të ulët nuk e obligon AK-në ta shpallë fituese, nëse nuk janë përmbushur kriteret teknike dhe ligjore të përgjegjshmërisë, por njëkohësisht AK duhet të ketë kujdes në vendimmarrje për të siguruar përdorim racional të buxhetit publik, në përputhje me parimet e nenit 1 të LPP-së.

Pretendimi Ankimor 7

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues, përveç faktit që nuk i ka vlerësuar drejtë, faktikisht dhe juridikisht ofertat e operatorëve konkurrues e veçanërisht të ankueses, nuk i ka trajtuar në merita dhe nuk i ka shqyrtuar pretendimet e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim. Si pasojë e mos trajtimit dhe vlerësimit të këtyre pretendimeve, AK ka nxjerrë një vendim pa kurrfarë arsytimi, çka sipas ankuesit përbën shkelje të dispozitave të Konventës dhe Kushtetutës, të cilat do t'i elaborojë më tej në ankesë.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 7

Pas analizimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe shqyrtimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues dhe përgjigjes ndaj Kërkesës për Rishqyrtim, eksperti shqyrtues konstaton si vijon:

Autoriteti Kontraktues ka listuar në vendimin e tij arsyet e eliminimit të ofertës së ankuesit, duke përmendur mospërputhjet teknike dhe ligjore të konstatuara gjatë vlerësimit. Megjithatë, arsytimi i dhënë ka qenë kryesisht formal dhe përmbljedhës, pa përfshirë një analizë të detajuar ligjore për secilën pikë të konstatuar, interpretim të dispozitave të LPP-së të zbatuara dhe krahasim të qartë me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Sipas nenit 108/A të LPP-së, Autoriteti Kontraktues është i obliguar që:

“Vendimi i miratuar duhet të jetë i arsytuar dhe të komunikohet me shkrim, në mënyrë që të mundësohet mbrojtje efektive juridike.”

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar, pasi edhe pse AK ka dhënë një arsyetim formal duke listuar shkaqet e eliminimit, mungesa e analizës së plotë ligjore dhe krahasimit të detajuar me kërkesat e dosjes së tenderit mund të ketë kufizuar transparencën dhe kuptueshmërinë e vendimit, si dhe aftësinë e palës ankues për të ushtruar në mënyrë efektive të drejtën e saj për ankesë.

Pretendimi Ankimor 8

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 59.4 të LPP-së, pasi nuk ka kërkuar sqarime për asnjë nga aspektet e ofertës së tij, ndonëse ky nen e lejon këtë kur ka

paqartësi ose devijime të vogla, gjë që do të mundësonte vlerësim të drejtë, objektiv dhe proporcional me kriteret e tenderit.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 8

Pas analizimit të pretendimit të paraqitur nga OE ankues dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, eksperti shqyrtues konstaton si vijon:

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 59.4 të LPP-së, pasi nuk ka kërkuar sqarime për asnjë aspekt të ofertës së tij, edhe pse ky nen përcakton që:

“Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë sqarime ose plotësime për dokumentet e ofertës së tyre, për aq kohë që këto sqarime nuk ndryshojnë ofertën në mënyrë substanciale.”

Gjithashtu, neni 72 i LPP-së kërkon që vlerësimi i ofertave të bëhet në mënyrë të drejtë, objektive dhe të paanshme, duke respektuar parimet e barazisë dhe konkurrencës së ndershme.

Edhe pse vendimi për të kërkuar sqarime mbetet në diskrecionin profesional të Autoritetit Kontraktues, eksperti shqyrtues vlerëson se kërkimi i sqarimeve në rastet kur ka paqartësi ose devijime të vogla – që nuk ndryshojnë ofertën materialisht – do të ishte në favor të zhvillimit të një procedure më transparente, konkurruese dhe në përputhje me parimet e nenit 1 të LPP-së për përdorim efikas dhe optimal të fondeve publike.

Pretendimet e Ankuesit ndaj Arsyes së Eliminimit

Ankuesi kundërshton arsyet e eliminimit të tij nga AK, duke i paraqitur si pretendime të veçanta:

Pretendimi Ankimor 9

AK ka eliminuar ankuesin me arsyetimin se katalogu i ofertës është në gjuhën gjermane dhe nuk përputhet me katalogun në faqen e internetit të prodhuesit. Ankuesi pretendon se katalogu është në gjuhën gjermane sepse prodhuesi është gjerman, se e kanë marrë fizikisht gjatë vizitës në Zvicër më 26.03.2025, dhe se ndryshimet me website-in janë për shkak se ai është version i vjetër (2002). Për më tepër, ata kanë përkthyer në shqip pjesët esenciale të katalogut.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 9

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të pretendimit të OE ankues dhe dokumentacionit të dorëzuar, konstaton si vijon:

Autoriteti Kontraktues ka eliminuar ofertën e ankuesit me arsyetimin se katalogu ishte në gjuhën gjermane dhe nuk përputhej me katalogun në faqen zyrtare të prodhuesit, duke theksuar se specifikimet në website nuk i plotësonin kërkesat e tenderit.

Në Dosjen e Tenderit (Kapaciteti Teknik dhe Profesional, pika 3) është kërkuar që operatorët ekonomikë të dorëzojnë katalogë ose broshura me specifikime të detajuara për produktet e ofertës. Katalogët, si dokumente që përmbajnë specifikimet teknike, konsiderohen pjesë thelbësore e ofertës.

Sipas nenit 13.4 të LPP-së, dokumentet e ofertës duhet të jenë në gjuhën shqipe, serbe ose angleze. Ndërsa, në këtë rast, katalogu i dorëzuar nga OE ankues ka qenë në gjuhën gjermane,

me përkthim të pjesshëm të disa pjesëve esenciale të kryer nga vetë kompania ofertues.

Në Opinionin nr.7 të KRPP-së, datë 22.11.2022, thuhet qartë se: “Kur një operator ekonomik dorëzon specifikime teknike në një gjuhë tjetër, kjo barazohet me mosdorëzim të dokumentit, pasi pengon AK të ketë njohuri të drejtpërdrejtë për përmbajtjen. Specifikimet teknike të çdo produkti që ka relevancë ndërkombëtare zakonisht janë në dispozicion në gjuhën angleze. Kur ato nuk janë në dispozicion, OE duhet të dorëzojë një përkthim të certifikuar në anglisht për specifikimet teknike.”

Ndërsa sa i përket arsytimit të AK-së për mospërputhjen me katalogun në faqen zyrtare të prodhuesit, eksperti shqyrtues vlerëson se kjo nuk ka qenë kërkesë e përcaktuar në dosjen e tenderit dhe nuk mund të përdoret si arsye e pavarur për eliminimin e ofertës.

Pretendimi i OE ankues vlerësohet si pjesërisht i bazuar, pasi: • Arsytimi për gjuhën e katalogut qëndron, duke qenë se mungesa e përkthimit të certifikuar është e barasvlershme me mosdorëzim të dokumentit; • Ndërsa arsytimi për mospërputhjen me faqen zyrtare nuk qëndron, pasi nuk ishte kërkesë e parashtruar në dosjen e tenderit.

Pretendimi Ankimor 10

AK ka eliminuar ankuesin me arsytimin se materiali i tubave është PVC dhe jo PE ose PP siç kërkohet në DT. Ankuesi pretendon se ka ofertuar me tubat e kërkuar PE dhe PP dhe ka paraqitur certifikata të lëshuara nga Europaverband Hochwasserschutz e.V. që vërtetojnë përputhshmërinë me standardet evropiane të mbrojtjes nga përmbytjet.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 10

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të pretendimit të OE ankues dhe dokumentacionit të dorëzuar në platformën e-prokurimit, konstaton si vijon:

Ankuesi pretendon se ka ofertuar tuba të prodhuar nga PE dhe PP, duke dorëzuar certifikata të lëshuara nga Europaverband Hochwasserschutz e.V. që sipas tij vërtetojnë përputhshmërinë me standardet evropiane të mbrojtjes nga përmbytjet.

Në Dosjen e Tenderit (Aneksi 1 – Specifikimet Teknike) është kërkuar qartë: “Materiali: PE (polietilen) ose PP (polipropilen), me dy shtresa.”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës rezulton se:

Certifikatat e lëshuara nga Europaverband Hochwasserschutz e.V. janë certifikata testimi dhe miratimi për performancën teknike të sistemit, që vërtetojnë rezistencën dhe funksionalitetin e produktit për mbrojtje nga përmbytjet,

Por ato nuk përmbajnë deklaram mbi përbërjen materiale PE ose PP, siç është kërkuar në specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues nuk është i bazuar, pasi nuk është paraqitur dëshmi që tubat e ofertuar janë të prodhuar nga PE ose PP.

Pretendimi Ankimor 11

AK ka eliminuar ankuesin me arsyetimin se ventilet lidhëse janë Storz 55 në vend të Storz 110A. Ankuesi pretendon se prodhuesi i tyre ofron ventilet Storz 110A dhe ato janë standarde për produktet e ofruara.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 11

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të pretendimit të OE ankues dhe dokumentacionit të ofertës, konstaton se Autoriteti Kontraktues ka eliminuar ofertën me arsyetimin se ventilat lidhës të ofertuar janë të standardit Storz 55 dhe jo Storz 110A, siç është kërkuar në Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Dosjes së Tenderit ku përcaktohet: “Ventilat lidhëse: 4” Storz 110A për mbushjen dhe shkarkimin e ujit.”

Nga dokumentet e ofertës rezulton se janë paraqitur specifikime për Storz 55, ndërsa nuk është paraqitur asnjë dëshmi që tubat e ofertuar përfshijnë ventila të standardit të kërkuar 4” Storz 110A.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues nuk është i bazuar, pasi në mungesë të dëshmisë së qartë për përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me DT-në dhe Ligjin për Prokurimin Publik gjatë eliminimit të ofertës.

Pretendimi Ankimor 12

AK ka eliminuar ankuesin me arsyetimin se pikat mbushëse nuk janë të detajuara dhe nuk garantojnë mbushjen nga një pikë e vetme. Ankuesi pretendon se pikat mbushëse janë të centralizuara sipas sistemit të ofruar dhe përmbushin kriteret e DT.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 12

Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin e OE ankues dhe dokumentacionin e dorëzuar në ofertë.

Në arsyetimin për eliminim, AK ka konstatuar se pikat mbushëse të ofertës nuk janë të detajuara dhe nuk garantojnë mbushjen nga një pikë e vetme, duke vlerësuar se kjo nuk përmbush kërkesat e Aneksit 1 të DT-së.

Nga shqyrtimi i specifikimeve teknike të Dosjes së Tenderit, rezulton se nuk është paraparë kërkesa që sistemi të ketë pikë të vetme mbushjeje, por është kërkuar që sistemi të sigurojë mbushje dhe zbrazje të shpejtë përmes ventilave lidhës standard 4” Storz 110A.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar, pasi eliminimi është bërë mbi bazën e një kriteri që nuk ishte i përcaktuar në DT, ndërsa në rast paqartësie AK ka pasur mundësi të kërkojë sqarime shtesë, në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së, duke mos ndryshuar materialisht ofertën.

Pretendimi Ankimor 13

AK ka eliminuar ankuesin me arsyetimin se gjatësia e seksioneve të tubave është deri 20m ndërsa kërkohen seksione prej 100m dhe 200m. Ankuesi pretendon se në katalogun e ofruar gjatësia e tubave është deri në 200m, siç kërkohet në DT.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 13

Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin e OE ankues se gjatësia e tubave të ofertuar është deri në 200 m, siç kërkohet në Dosjen e Tenderit.

Në arsyetimin për eliminim, AK ka konstatuar se gjatësia e seksioneve të tubave të ofertuar është deri 20 m dhe nuk përmbush kërkesën për seksione prej 100 m dhe 200 m, sipas Aneksit 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ku është kërkuar:

“Gjatësia e seksioneve të tubave: 100 m dhe 200 m.”

Nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar rezulton se:

Nuk është specifikuar që tubat ofrohen në seksione me gjatësi 100 m ose 200 m.

Përmenden vetëm gjatësi të seksioneve deri në 20 m, ndërsa nuk ka asnjë përshkrim apo tabelë që dëshmon ekzistencën e tubave me gjatësi të kërkuar.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues nuk gjen mbështetje, pasi dokumentacioni i ofertës nuk dëshmon që tubat ofrohen në gjatësi prej 100 m dhe 200 m, siç është kërkuar në DT.

Pretendimi Ankimor 14

AK ka eliminuar ankuesin me arsyetimin se mungon Certifikata e Konformitetit CE. Ankuesi pretendon se ka paraqitur certifikatat e firmës Beaver Schutzsysteme AG të lëshuara nga shoqata EVH, që dëshmojnë përputhshmërinë me standardet e BE për mbrojtjen nga përmbytjet.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 14

Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin e Operatorit Ekonomik ankues, i cili ka deklaruar se dokumentet e dorëzuara nga Europaverband Hochwasserschutz e.V. (EVH) dëshmojnë përputhshmërinë e produktit me standardet evropiane për mbrojtjen nga përmbytjet.

Nga shqyrtimi i dokumenteve në platformën e-prokurimit, rezulton se në FDT – Kapaciteti Teknik dhe Profesional, pika 4, është kërkuar qartë:

“Sistemi mobil për mbrojtjen nga vërshimet dhe përmbytjet duhet të përmbajë Certifikimin CE. Duhet të dorëzohet kopje e Certifikatës së Konformitetit CE që tregon përputhshmërinë e produktit me standardet dhe kërkesat e BE për siguri, shëndetësi dhe mbrojtje mjedisore.”

Në arsyetimin për eliminim, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar: “Mungon Certifikata e Konformitetit CE e kërkuar për produktet kryesore të ofertës.”

Eksperti shqyrtues, nga shqyrtimi i dokumenteve të ofertës, ka konstatuar se është dorëzuar Certifikata ISO 9001:2015 për kompaninë prodhuese Beaver Schutzsysteme AG, duke plotësuar kërkesën për sistemin e menaxhimit të cilësisë, por nuk është dorëzuar Certifikata e Konformitetit CE. Dokumentet e paraqitura nga EVH janë certifikata testimi dhe miratimi cilësie, si Award Certificates dhe Additional Test Certificates, të cilat vërtetojnë performancën teknike të sistemeve mobile për mbrojtje nga përmbytjet, por nuk zëvendësojnë Certifikatën e Konformitetit CE. CE është një Deklaratë Konformiteti ligjërish e detyrueshme, që vërteton

përputhshmërinë e produktit me direktivat dhe standardet e BE-së për siguri, shëndet dhe mbrojtje mjedisore, dhe lëshohet vetëm nga prodhues ose organ i autorizuar certifikues. Eksperti shqyrtues vlerëson se, edhe pse dokumentet e dorëzuara nga EVH vërtetojnë performancën teknike të produktit, mungesa e Certifikatës së Konformitetit CE të kërkuar në DT bën që pretendimi i OE ankues të mos gjejë mbështetje ligjore të plotë.

Pretendimi Ankimor 15

AK ka eliminuar ankuesin me arsyetimin se mungon vula në raportin e vlerësimit të sistemit mobil për mbrojtje nga përmbytjet. Ankuesi pretendon se raporti origjinal i lëshuar nga Ministria e Hungarisë është i vulosur, ndërsa përkthimi në anglisht nuk ka vulë pasi është bërë nga OE për lehtësimin e shqyrtimit nga AK. Ata janë të gatshëm ta përkthejnë me përkthyes të licencuar nëse kërkohet.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 15

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të pretendimit të OE ankues dhe dokumentacionit të dorëzuar, konstaton si vijon:

Autoriteti Kontraktues ka eliminuar ofertën me arsyetimin se raporti i vlerësimit të sistemit mobil për mbrojtjen nga vërshimet dhe përmbytjet nuk është i vulosur. Sipas FDT – Kapaciteti Teknik dhe Profesional, pika 5, është kërkuar:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një raport vlerësimi të vlefshëm për sistemin mobil për mbrojtjen nga vërshimet dhe përmbytjet. Raporti duhet të përmbajë të dhëna mbi efikasitetin teknik dhe performancën e sistemit të propozuar, të verifikuar nga një institucion i pavarur përkatës.”

Nga dokumentacioni rezulton se raporti origjinal i dorëzuar është i vulosur nga Ministria e Punëve të Brendshme të Hungarisë, ndërsa përkthimi në anglisht është bërë nga vetë OE, për lehtësimin e shqyrtimit nga AK, pa vulë të përkthyesit të licencuar.

Vlen të theksohet se raporti origjinal përmban vulën dhe është lëshuar nga Ministria e Hungarisë, e jo nga një institut i pavarur, siç kërkohet në Dosjen e Tenderit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se arsyeja e eliminimit lidhur me mungesën e vulës në përkthim përbën mangësi formale, e cila mund të ishte sqaruar përmes një përkthimi të certifikuar dhe të vulosur nga përkthyes i licencuar, pa ndryshuar ofertën në thelb.

Pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar, pasi mungesa e vulës në përkthim është një çështje formale që mund të sqarohet, ndërkohë që raporti i dorëzuar nuk përmbush plotësisht kërkesën për t’u lëshuar nga një institut i pavarur, siç kërkohet në DT.

PËRFUNDIM

Mbështetur në analizën e pretendimeve dhe dokumentacionit të shqyrtuar, ankesa vlerësohet si pjesërisht e bazuar.

Procesi i vlerësimit nuk është zhvilluar në përputhje të plotë me nenin 1 të LPP-së, i cili synon sigurimin e një sistemi të drejtë, transparent dhe ekonomik të prokurimit publik. Po ashtu, nuk janë respektuar në mënyrë të plotë nenet 6 dhe 7 të LPP-së, që garantojnë përdorim efikas të

fondeve publike dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë, si dhe neni 59.4 i LPP-së, i cili përcakton se:

“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.”

Nga shqyrtimi i pretendimeve ankimore, vërehet se OE i rekomanduar për kontratë, i cili ka ofruar çmimin më të lartë, nuk ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Analiza tregon se, pavarësisht se disa çështje në ofertën e ankuesit mund të ishin sqaruar, ndërsa për disa të tjera mungonin dokumente në përputhje të plotë me kërkesat e DT-së, Autoriteti Kontraktues nuk ka zhvilluar proces vlerësimi në pajtim me nenin 59.4 të LPP-së dhe parimet e përgjithshme të ligjit.

Rekomandohet që Paneli Shqyrtues ta aprovojë ankesën si pjesërisht të bazuar dhe t’i kërkojë Autoritetit Kontraktues rivlerësimin e ofertave, duke siguruar që çdo sqarim dhe plotësim të bëhet në përputhje të plotë me nenin 59.4 të LPP-së, për të garantuar një proces të drejtë, transparent dhe me përdorim racional të buxhetit publik.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e OSHP-së lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë OSHP-në dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e raportit të ekspertit shqyrtues vlerësimet e tij janë pjesërisht të pranueshme

Lidhur me pretendimet e “OE EING” SHPK me nr. të ankesës 2025/0535

Gjatë administrimit të të gjitha shkresave të kësaj lënde përfshirë provat e ankuesit si dhe përfshirë aktet dhe veprimet e AK, duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm, mund të konstatohet se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59 dhe 60 të LPP, përfshirë edhe dispozitat e përcaktuara me Rregulloren e Prokurimit Publik, ngase arsyetimi i autoritetit kontraktues i shprehur në Letrën Standarde për elimin e këtij OE ankues është i

pabazuar, këtë e ka konstatuar edhe eksperti shqyrtues i cili raportin e ekspertizës e ka hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Panelit shqyrtues konsideroj se pretendimet e ankuesit janë të bazuara sepse ankuesi ka dëshmuar se: Certifikata CE e dorëzuar nga OE ankues është lëshuar nga prodhuesi dhe përmban të gjitha elementet e nevojshme, ndërsa për këtë produkt zbatohet sistemi AVCP 4, i cili lejon vetë-certifikimin pa nevojë për notified body; materialet e ofruara PVC dhe PU janë të dizajnuara për përdorim të përkohshëm gjatë situatave emergjente për vërshime, janë të testuara për mbajtjen e presionit të ujit dhe i përgjigjen 100% natyrës së kontratës dhe specifikimit të dosjes së tenderit, me çrast AK duhet ta ketë parasysh nenin 6 dhe nenin 59.4 të LPP; autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar specifikisht që lidhja STORZ të jetë standarde e produktit në katalog, por vetëm që të jetë pjesë e produktit të ofruar, sepse kërkesa e DT-së nuk ka përcaktuar qartë nëse kjo lidhje duhet të jetë e deklaruar si standard apo mund të ofrohet si pjesë e furnizimit; lidhur me atë se *Nuk ka informacion të detajuar për mundësinë e lidhjes së pikës mbushëse në një pikë të vetme në Dosje të Tenderit* tregon se nuk është specifikuar në mënyrë eksplicite kërkesa që mbushja e sistemit të bëhet në një pikë të vetme, Në përputhje me nenin 56.3 dhe 59 të LPP-së, operatorët ekonomikë nuk mund të eliminohen për kritere të papërcaktuara në DT-së, ndërsa lidhur me gjatësin e tubave 100m dhe 200m siç kërkohet në DT, por njëkohësisht evidentohet se ekziston mundësia teknike për prodhim ose konfigurim modular të këtyre gjatësive, kështu që AK mund të kërkoj sqarime; lidhur me numri i prokurimit në sigurimin e tenderit nuk përputhet me numrin e aktivitetit sipas DT-së, PSH në konsistencë edhe me vendimet tjera 2023/0993 ku është konstatuar se gabimet teknike në sigurimin e tenderit nuk e bëjnë ofertën të papranueshme, përderisa dokumenti përmban të gjitha elementet e tjera të kërkuara dhe ekzistenca e tij është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave.

Ndërsa pretendimet e ankuesit ndaj OE të rekomanduar për kontratë, lidhur me plotësimin e Marrëveshjes (Deklaratës) për themelimin e grupit, GOE i rekomanduar përveq qe ka dorëzuar deklarata individuale të ndara nga DIGA Solutions L.L.C. (lider), ED-Construction Sh.P.K. (anëtar) dhe IMK Sh.P.K. (anëtar), të cilat: Nuk kanë ofruar marrëveshjen (formularin standardë) të cilën e ka miratuar KRPP-ja dhe është obligative për të gjithë pjesëmarrësit që shprehin interesim për formimin e GOE ku në Anëtarët e grupit lidhim këtë marrëveshje me të cilën deklarojmë janë të përfshiera 8 pika lidhur me detyrat dhe përgjegjësit e çdonjërit pjesë e GOE (Liderit dhe anëtarëve tjerë pjesëmarrës). Nuk përmbajnë përqindjet e pjesëmarrjes, Nuk përcaktojnë përgjegjësitë e secilit anëtar dhe sipas nenit 10.1 të Udhëzuesit Nr. 001/2023 (i ndryshuar me 002/2024), mungesa e këtij formulari standard është kusht administrativ eliminues. Pra, GOE i rekomanduar nuk ka përmbushur kërkesën ligjore për dorëzimin e Marrëveshjes për themelimin e grupit, të miratuar nga KRPP-ja pavarësisht mangësive në publikimin e formularit nga AK në DT, 9 Aneksi 7 duke qenë se operatorët ekonomikë janë të obliguar të sigurojnë që dokumenti të përmbajë të gjitha elementet ligjore të përcaktuara.

Njëherit OE i rekomanduar për kontratë ka edhe mangësi tjera të cilat AK i ka marrë si të mirëqena përkundrazi që OE ka çmim shumë më të lartë se sa OE ankues. Në dokumentacione OE të rekomanduar nuk është bashkangjitur asnjë dëshmi apo konfirmim nga vetë prodhuesi (Environment Solutions AsP) që vërteton statusin e Solomon Consultants si përfaqësues zyrtar apo distributor i autorizuar për produktet në fjalë. Kjo krijon pasiguri lidhur me përmbushjen e plotë të kërkesës së DT-së, e cila kërkon që autorizimi të lëshohet nga prodhuesi ose nga një distributor i dedikuar për projektin; GOE i rekomanduar nuk ka ofruar dëshmi të plotë për materialet PP dhe PE, siç është kërkuar; Nuk ka asnjë referencë apo dokument që dëshmon përputhshmërinë e lidhjeve hidraulike me standardet ISO-16028 ose ISO-7241 Lloji A, siç është kërkuar në specifikimet teknike.

Ankuesi ka paraqitur edhe pretendime ankimore ndaj OE AGRO INVEST1 SH.P.K.; Beaver Schutzsysteme AG; LORD GROUP SH.P.K.; Ermal Sylaj B.I. i cili është ankues në këtë procedurë, Dhe në bazë të këtij pretendime ankimore GOE ka dorëzuar katalogë të plotë teknikë, mungesa e përkthimit zyrtar në një nga gjuhët e lejuara përbën mangësi ligjore që cenon pranueshmërinë e ofertës, në përputhje me nenin 13.4 të LPP-së, nenin 13 të Rregullores për Prokurim Publik dhe Opinionin Nr. 7 të KRPP-së, gjë që kjo ofertën e tij/saj e bënë komplet të papërgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit. I njëjti GOE ka ofruar edhe një raport të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Hungarisë, e cila është përdorues i produktit, ndërsa nuk rezulton të jetë institut i pavarur vlerësimi teknik, siç kërkohet në mënyrë të qartë në DT. Po ashtu ky GOE nuk ka ofruar asnjë të dhënë teknike (dokument, katalog apo broshurë) që dëshmon për përmbushjen e këtyre kërkesave për vinçin hidraulik.

Ankuesi ka paraqitur edhe pretendime ndaj GOE: HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K, por në konsistencë me vendimet e OSHP, PSH nuk do të lëshohet në konstatime ndaj këtij GOE, pasi që i njëjti është eliminuar dhe nuk ka paraqitur ankesë në OSHP për të mbrojtur eliminimin e tij, kështu që është pajtuar me rezultatin e nxjerrë nga AK se i njëjti është i papërgjegjshëm.

Si përfundim, mund të konstatohet se Ankesa e OE është e bazuar dhe AK aktivitetin e prokurimit duhet ta kthejë në ri-vlerësim mbi bazën e kësaj anekese të këtij OE ankues i cili rezulton të jetë më i lirë për 494,800.00 më i lirë se OE i rekomanduar për kontratë nga AK.

Lidhur me pretendimet e “OE AGRO INVEST 1” SHPK me nr. të ankesës 2025/0560

Ankuesi në ankesën e tij ka paraqitur pretendimet e tij ankimore ndaj GOE të rekomanduar për kontratë dhe këto pretendime kualifikohen si të bazuara por të cilat në këtë rast nuk ka nevoj që të përsëriten sërish ngase po thuajse të njëjtat janë të evidentuara në ankesën 2025/0535, ku rezulton se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm duke shtuar se gjetjet nga dokumentacioni i ofertës se OE të rekomanduar: Autorizimi i dorëzuar është lëshuar nga Solomon Consultants d.o.o. Beograd-Savski Venac (Serbi) më 12.02.2025 dhe përmban deklaratën se kjo kompani është përfaqësues ekskluziv i Environment Solutions AsP për territorin e Kosovës, duke autorizuar DIGA Solutions LLC për shitjen e produkteve të

Environment Solutions AsP në Kosovë, përfshirë tenderët publikë. Kështu që Autorizimi nuk është lëshuar direkt nga prodhuesi (Environment Solutions AsP), siç do të përmbushte më qartë kërkesën ligjore. Nuk është bashkangjitur kopja e dokumentit nga prodhuesi që vërteton se Solomon Consultants është distributor i autorizuar, edhe pse referohet në tekst si dokument i bashkangjitur. Autorizimi është i përgjithshëm për territorin e Kosovës dhe nuk përmban referencë specifike për këtë projekt/tender, siç është kërkuar në dosjen e tenderit për autorizim të dedikuar. Pretendimi i OE ankues është i bazuar, pasi autorizimi i dorëzuar nuk dëshmon në mënyrë të plotë dhe të qartë lidhjen zyrtare të lëshuesit me prodhuesin dhe nuk është specifik për këtë projekt konkret, siç kërkohet në dokumentacionin e tenderit.

Ankuesi ka paraqitur pretendime ankimore të cilat janë kundër eliminimit të ofertës së tij nga ana e AK, por që nuk janë argumente të mjaftueshme se oferta e OE ankues është e përgjegjshme për këtë aktivitet të Prokurimit ngase ankuesi Sipas nenit 13.4 të LPP-së, dokumentet e ofertës duhet të jenë në gjuhën shqipe, serbe ose angleze. Ndërsa, në këtë rast, katalogu i dorëzuar nga OE ankues ka qenë në gjuhën gjermane, me përkthim të pjesshëm të disa pjesëve esenciale të kryer nga vetë kompania ofertues. Kjo e bënë ofertën e OE të papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, janë të qëndrueshme edhe arsyet tjera për eliminimin e këtij OE ankues i cili nuk ka paraqitur dëshmi që tubat e ofertuar janë të prodhuar nga PE ose PP; Nga dokumentet e ofertës rezulton se janë paraqitur specifikime për Storz 55, ndërsa nuk është paraqitur asnjë dëshmi që tubat e ofertuar përfshijnë ventila të standardit të kërkuar 4” Storz 110A, etj, andaj PSH konsideron se nuk ka nevoj të lëshohet në konstatime tjera përderisa këto janë më se të mjaftueshme dhe përcaktuese për një vendimmarrje meritorie lidhur me këtë ankesë.

Kështu që ankesa e OE ankues kualifikohet si pjesërisht e bazuar, vetëm ndaj pretendimeve ankimore ndaj OE të rekomanduar për kontratë, por e pamjaftueshme që të mbroj eliminimin e ofertës së tij nga ky aktivitet i prokurimit.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me 163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet -Ritender me numër të prokurimit 616-25-2547-1-1-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim, ndërsa kërkon nga AK-ja që gjatë Rivlersimit ti përmbahet në tërsi dispozitave të LPP-se, dhe gjetjeve në këtë vendim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - EING COM SH.P.K., " AGRO INVEST 1 " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: